



Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë
Fakulteti i Shëndetit Publik
Departamenti i Infermierisë

TEMË DIPLOME

Master shkencor në "Shkenca Infermierore"

MATJA E FENOMENIT TE BULLIZMIT NË SHKOLLAT 9-VJEÇARE, TË QYTETIT TË VLORËS

Punoi : Denisa Malaj

Udhëheqës Shkencor: Msc. Phd Enkelejd Mehilli

Vlore, 2020

Tabela e përmbajtjes

Përmbajtja e tabelave	4
Përmbajtja e grafikëve	5
Abstrakt	6
Abstract	7
Hyrje	8
I. Kuadri teorik.....	9
I.a Cfare eshte bullizmi ?	9
I.b Format e shfaqjes se bullizmit.....	10
I.c Shkaqet e bullizmit	12
I.d Pasojat e bullizmit	13
I.e Faktorët që ndikojnë në sjelljet bulliste	13
1.f Mënyrat e parandalimit të bullizmit në shkolla	14
II. Metodologjia e punimit.....	16
Qëllimi	16
II.a Objektivat e punimit.....	17
II.b Mostra e marrë në studim	17
II.c Instrumenti I përdorur për të mbledhur të dhënat.....	17
II.d Lloji I të dhënave dhe mënyra e mbledhjes	18
II.e Përpunimi I të dhënave	18
II.f Vlefshmëria e të dhënave	19
II.g Kufizime të punimit	19
II.h Hipotezat e punimit.....	19
II.i Etika e studimit.....	20
III. Analizimi I të dhënave të punimit	21
a. Analizimi I të dhënave të përgjithshme të nxënësve të anketuar	21
b. Fenomeni I viktimizimit.....	26
c. Grindjet fizike ose agresioni.	27
d. Vlerësimi I fenomenit të bullizmit.....	29
e. Sjellje bulliste, agression apo viktimë e bullizmit?	30
f. Vlerësimi I marrëdhënieve midis variablave	31

IV.	Diskutim	33
a.	Vlerësimi I hipotezave të punimit	35
V.	Konkluzione	36
VI.	Rekomandime	39
VII.	Anekse 1	40
VIII.	Referenca	43

Përmbajtja e tabelave

Tabela 1 Cronbach alpha per Bullismin.....	19
Tabela 2 Cronbach alpha per Viktimizimin.....	19
Tabela 3 Cronbach alpha per Grindjet fizike	19
Tabela 4 Numri i nxënësve të anketuar sipas shkolla ku studiojnë	21
Tabela 5 Gjinia e nxënësve të anketuar	22
Tabela 6 Moshë e të intervistuarve.....	22
Tabela 7 Klasa e të anketuarve	23
Tabela 8 Vendbanimi i nxënësve të intervistuar.....	23
Tabela 9 Mesatarja e peshës sipas moshës së nxënësve.....	23
Tabela 10 Vlerat ekstreme të BMI	24
Tabela 11 Mesatarja e BMI	24
Tabela 12 Mesatarja e gjatësisë sipas moshës së nxënësve të anketuar	25
Tabela 13 Mbarëvajtja mësimore	25
Tabela 14 Fenomeni i viktimizimit	26
Tabela 15 Shtrirja e viktimizimit ndaj meshkujve dhe femrave	27
Tabela 16 Grindjet fizike.....	28
Tabela 17 Shtrirja e grindjeve fizike midis femrave dhe meshkujve.....	29
Tabela 18 Marrëdhënia midis sjelljeve agresive dhe gjinise.....	29
Tabela 19 Përfshirja në fenomenin e bullizmit	29
Tabela 20 Shtrirja e bullizmit midis femrave dhe meshkujve	30
Tabela 21 Marrëdhënia midis gjinise dhe bullizmit	30
Tabela 22 Sjellje bulliste apo viktimë e bullizmit?	31
Tabela 23 Vlerësimi i marrëdhënieve mes variablave	32
Tabela 24 Ndikimi i BMI në fenomenet e bullizmit.....	32

Përmbajtja e grafikëve

Grafiku 1 Numri i nxënësve të anketuar sipas shkolla ku studiojnë	21
Grafiku 2 Gjinia e nxënësve të anketuar	22
Grafiku 3 BMI e nxënësve të intervistuar.....	24
Grafiku 4 Mbarëvajtja mësimore	26
Grafiku 5 Viktimizim	27
Grafiku 6 Shtrirja e grindjeve fizike midis femrave dhe meshkujve.....	28
Grafiku 7 Shpërndarja e sjelljeve bulliste midis gjinisë	30

Abstrakt

Bullizmi në shkollë është një problem madhor I hasur në të gjithë botën, I cilësuar si një prej sjelljeve më të shpeshta antisociale në mesin e fëmijëve dhe adoleshentve. I përkufizuar si një përsëritje e qëllimshme e veprimeve negative fizike, verbale apo relative, me qëllim shqetësimin e fëmijëve të tjerë, në situata ku forca nuk është e dyanshme, bullizmi po kthehet në një problem të shëndetit publik. Sipas të dhënave të UNICEF apo dhe shumë studimeve në këtë fushë, bullizmi shkakton humbje të sigurisë, uljes të performancës mësimore si dhe dëmtim të shëndetit fizik apo atij mendor. Në kohët e fundit, fokusi I kërkimeve po drejtohet ndaj evidentimit të viktimave të bullizmit, të cilët janë më të ekspozuar ndaj dëmtimeve shëndetsore, mendore apo sulmeve agresive. Shumë nxënës apo studentë nuk janë ende të qartë për këto sjellje, duke I vendosur ato shpesh herë në kuadrin e një shakaje apo argëtimi.

Qëllimi I këtij punimi është vlerësimi I fenomenit të bullizmit, viktimizimit si dhe sjelljeve agresive, në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Vlorës, shpërndarjen e këtyre sjelljeve sipas moshës, gjinisë si dhe ndikimi I tyre në performancën shkollore.

Metoda e studimit: Ky është një studim deskriptiv analitik, ku u përfshinë N=475 nxënës të 5 shkollave 9-vjeçare të qytetit të Vlorës. Mbledhja e të dhënave u realizua nëpërmjet pyetësorit të standartizuar Illinois Bully Scale, I cili vlerëson fenomenin e bullizmit, viktimizimit apo sjelljeve agresive.

Rezultatet e punimit: Shumica e nxënësve të intervistuar, 53% ishin femra. 66% jetonin në qendër të qytetit dhe 51% vetëdeklarorin se kishin një ecure shumë të mirë mësimore. Është llogaritur BMI e nxënësve të intervistuar në bazë të gjatësisë dhe peshës që ata kanë ofruar, e cila ka rezultuar mesatarisht 19.55. Shumica e nxënësve, 43%, nuk janë të përfshirë në fenomenin e viktimizimit, 66% shfaqin sjellje të lehta bullizmi dhe 55% janë lehtësisht të përfshirë në sjellje agresive. pas realizimit të chi-square, rezultoi se janë meshkujt ata të cilët janë më të përfshirë në këto fenomene ($P < 0.05$). Të treja fenomenet kishin ndikim sinjifikant të ndërsjelltë ndaj njera-tjetrës. Fenomenet agresive nxisin bullizmin apo viktimizimin. Një viktimë mund të kthehet në bullist, madje të manifestojë dhe agresion, si dhe anasjelltas. Nxënësit me mbarëvajtje të ulët mësimore ishin më të përfshirë në sjellje bulliste apo agresive. Nëse do të krahasojmë sjelljet me njëratjetrën, nxënësit e intervistuar manifestonin më tepër sjellje agresive, më tej bulliste dhe më pak të përfshirë në rolin e viktimës.

Rekomandime: Meqënëse nga punimi rezultoi se meshkujt ishin më të përfshirë në sulme apo sjellje bullizmi, rekomandohet kanalizimi I tyre në aktivitete krijuese apo sportive, për ti shpërqëndruar nga sjellje të tilla. Të rinjtë duhet të kuptojnë ku përfundon shakaja dhe ku fillon abuzimi apo shqetësimi I bashkëmoshatarve, ata duhet të fuqizohen të denoncojnë të gjitha rastet kur ndihen të kërcënuar apo janë në dijeni të rasteve të tilla. Meqënëse sjelljet si bullizmi, agresioni apo viktimizimi, janë në fillimet e veta, ndërhyrjet parandaluese në këtë fazë mund të rezultojnë efikase.

Fjalë kyçe: Bullizëm, viktimë, agresion, fëmijë, adoleshent

Abstract

Bullying in schools is a significant problem worldwide and is one of the most common antisocial behaviors among children and adolescents. Defined as a intentional repetition of negative physical, verbal or relational actions, intended to disturb other children, in situations where the force is not reciprocal, bullying is turning into a public health problem. According to UNICEF data or many studies in this field, bullying causes loss of security, reduced academic performance and damage physical and mental health. Recently, the focus of research is identifying victims of bullying who are more exposed to health damage or aggressive attacks. Many pupils or students are not yet clear about these behaviors, often placing them in the context of a joke or fun.

The purpose of this paper is to assess the phenomenon of bullying, victimization and aggressive behaviors in secondary schools in the city of Vlora, the distribution of these behaviors by age, gender and their impact on school performance.

Method: This is a descriptive analytic study, which included $N = 475$ students of 5 secondary schools of the city. Data collection was conducted through the standardized Illinois Bully Scale questionnaire, which assesses the phenomenon of bullying, victimization and aggressive behavior.

Results of the study: Most of the students interviewed, 53% were female. 66% lived in the center of the city and 51% declared that they had a very good academic performance. The BMI was calculated based on the height and weight they provided, which resulted in an average of 19.55. Most students, 43%, are not involved in the phenomenon of victimization, 66% exhibit mild bullying behaviors and 55% express mild aggressive behaviors. After performing chi-square, it turned out that boys are more involved in these phenomena ($P < 0.05$). All three phenomena had a significant mutual influence on each other. Aggressive behavior promotes bullying or victimization. A victim can turn into a bully, even manifest aggression, and vice versa. Students with low academic achievement were more involved in bullying or aggressive behavior. If we compare the behaviors with each other, the interviewed students manifested more aggressive behaviors, further bullying and less involved in the role of the victim.

Recommendations: Since the study showed that men were more involved in attacks or bullying behavior, it is recommended to channel them into creative or sports activities, to distract them from such behaviors. Young people need to understand where the joke ends and where the abuse or harassment begins, they need to be empowered to report all cases where they feel threatened or aware of such cases. Since behaviors such as bullying, aggression, or victimization are in their infancy, so preventative interventions at this stage may be effective.

Keywords: Bullying, victim, aggression, child, adolescent

Hyrje

Shkollat janë përgjegjëse për mirëqenien e fëmijëve dhe, kur kjo nuk ndodh, fëmijët janë të prekur thellësisht. Që në vitet e para të jetës nëpërmjet lojës, fëmijët shoqërohen, mësojnë standardet dhe zhvillojnë një ide kufijsh në lidhje me shoqerine. Ata mësojnë dhe ndjejnë kënaqësi të vazhdueshme në kërkimin e përvojave të reja, në të cilat është funksioni i shkollës të siguroj një hapësirë për mirëqenie. Përveç kënaqësisë personale, ky koncept i "mirëqenies" përfshin gjithashtu përpjekjet, angazhimin dhe të mësuarit. Nga ana tjetër, disa fëmijë përjetojnë periudha vështiresie lidhur me bashkëmoshatarët e tyre dhe janë viktima të bullizmit. Fëmijët e identifikojnë pushimin e drekes në shkollë si një hapësirë shumë të vlefshme që ata e duan, por gjithashtu si sferë në shkollë ku bullizmi ndodh më shpesh. Prandaj, institucioni shkollor është shumë kuptimplotë për fëmijët si mjet socializimi dhe mësimi. Përmes edukimit fëmijët kanë qasje në njohuri të reja, të prodhuara dhe sistemuara në shoqeri. Shkolla është gjithashtu një hapësirë e privilegjuar për promovimin e cilësisë së jetës në një fokus më të gjerë, nga perspektiva e ndërtimit të qytetarisë dhe zhvillimit të aktorëve të ndryshëm që përfshin ky univers. Kërkimet kanë treguar se, aktualisht, shkolla është shfaqur si një nga hapsirat e mundshme të dhunës, bullizmit dhe mungesa e disiplinës është prodhuar dhe riprodhuar në forma të ndryshme, në krahasim me atë që pritet nga konteksti i shkolles si një hapësirë për socializim dhe mbrojtje. Studimet e ndryshme në mbarë botën kanë treguar se, marrëdhëniet shoqërore mund të marrin forma specifike, të tilla si bullizmi midis bashkëmoshatarëve, si një fenomen që është një burim shqetësimi në rritje, jo vetëm për shkak të rritjes së tij por edhe për faktin që po prek gjithnjë me shume moshat me të reja kryesisht në vitet e para të shkolles. Kjo e shndërron atë në një problem të rëndë dhe të rëndësishëm të shëndetit social, edukativ, publik dhe atij mendor. (1)

Qëllimi i këtij punimi: Bullizmi ka një impakt të fuqishëm në shëndetin mendor, fizik dhe social të fëmijëve dhe adoleshenteve në vecanti dhe në shëndetin publik në teresi. (2)

Studimet e ndryshme kanë evidentuar se bullizmi shkakton pasoja të shumta në jetën e individëve e rrjedhimisht të nxenesve si pasoja psikologjike e somatike. (3), (4) Për shkak të rëndësisë së madhe që ka zënë ky fenomen në mbarë botën por edhe në vendin tonë, është zgjedhur të realizohet ky studim mbi fenomenin e bullizmit në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Vlores për të kuptuar sa është i përhapur ky fenomen tek nxenesit. Është një fenomen sa aktual dhe i prekshëm por ka shume pak studime në vendin tonë.

I. Kuadri teorik

1.1. Cfare eshte bullizmi ?

Bullizmi në shkollë njihet si një fenomen global i cili prek një pjesë të konsiderueshme të fëmijëve dhe adoleshentëve, e duke afektuar kështu edhe shoqëritë (5), (6)

Dan Olweus, një profesor i psikologjisë, ishte i pari që kreu në vitin 1970 një studim intensiv mbi bullizmin që ndodhte ndërmjet nxënësve suedezë, duke përdorur metodat e tij të kërkimit perkufizoi si më poshtë: "*Një person është viktimë e bullizmit kur ai ose ajo është i ekspozuar, në mënyrë të përsëritur dhe për një kohë të gjatë, ndaj veprimeve negative të një ose më shumë personash dhe ai ose ajo ka vështirësi ta mbrojë veten*"

Përkufizimet e sipërpërmendur bëjnë të qartë se dhuna është pjesë e bullizmit. Nga ana tjetër, edhe pse bullizmi është një formë e dhunës, ajo ka shkaqe thelbësisht të ndryshme nga format e tjera të dhunës. Ekziston një vijë e hollë ndarëse midis bullizmit dhe dhunës dhe hulumtimet tregojnë se ka një rritje të numrit të nxënësve të cilët gjithnjë e më shumë përdorin dhunën gjatë kohës së bullizmit. (7)

Studimet e realizuara në vende të ndryshme, kanë treguar e theksuar rritjen dhe përhapjen e këtij fenomeni vecanerisht në moshat e reja pavarësisht nëse një shoqëri është e zhvilluar apo është në zhvillim

Nga përkufizimi i Bullizmit vërehen tre elemente perberes që janë

1. **Qëllimi** (Agresori kërkon të demtojë dike)
2. **Përsëritja** (Agresori përsërit fenomenin në menzrë të herë pas herëshme).
3. **Fuqia e paekuilibruar** (Dhunuesi ka fuqi më të madhe se viktimat).
Error! Bookmark not defined..Error! Bookmark not defined..Error! Bookmark not defined.

Studimet e shumta të realizuara mbi fenomenin e bullizmit kanë treguar se në zhvillimin e tij luajnë rol tre aktore kryesor që janë:

1. Në grupin e parë futen **agresorët**, të cilët janë edhe autorët e kësaj sjelljeje agresive karakteristika kryesore të agresorëve janë impulsiviteti, agresiviteti, fuqia fizike dhe sjellja kontrolluese mbi të tjerët. Ata duket se kanë një perceptim pozitiv për dhunën dhe përdorin strategji kryesisht agresive për të administruar konfliktet e tyre personale, sepse nuk kanë aftësi zgjedhjeje për diçka ndryshe nga mënyra e zakonshme a tradicionale për zgjidhjen paqësore të konflikteve.

Agresoret nuk janë një grup homogjen. Disa agresore kanë aftësi sociale të zhvilluara mirë dhe përdorin bullizmin për të fituar ose për të ruajtur dominimin në grupin e tyre të bashkëmoshatarëve. Agresoret mund të kenë një qëndrim pozitiv ndaj dhunës dhe mungesën e ndjeshmërisë për viktimat e tyre. Përafërsisht 10% e agresoreve shfaqin norma të larta të bullizmit përgjatë kohës .13 % e nxënësve bullojnë në adoleshencën e hershme, por nuk janë më bullues në fund të shkollës së mesme. Djemte kanë më shumë gjasa të klasifikohen si agresore se vajzat. Agresoret kanë më shumë të ngjarë të shfaqin sjellje sfiduese , qëndrime negative ndaj shkollës, dhe të përdorin drogera . Agresoret gjithashtu mund të shfaqin gjendje ko-morbide, të tilla si mungesa e vemendjes , depresion, dhe çrregullim të sjelljeve.
Error! Bookmark not defined.

2. Në grupin e dytë futen **viktimat**, të cilët janë nxënësit që bien pre e bullizmit. Viktimat kanë prirje që të shfaqin nivele të larta të ankthit dhe të depresionit .Ata zakonisht kanë vetëbesim të ulët dhe aftësi të dobëta sociale, nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në veprimtaritë e shkollës dhe shfaqin shenja psikosomatike , kanë vështirësi për të besuar

të tjerët, shfaqin agresion, kanë mungesë sigurie, rrinë të izoluar etj. Të gjitha shfaqjet e mësipërme mund të zgjasin edhe me vite të tëra ^{Error! Bookmark not defined.}

Shumica e viktimave të bullizmit janë viktima pasive ose të nënshtruara (përkundrejt provokimeve / agresionit). Ata mund të jenë fizikisht më të vegjël, më pak të sigurt, më shumë anksioz, të pasigurtë apo të ndjeshëm se sa agresoret. Viktimat gjithashtu mund të kenë vështirësi në bërjen e miqve dhe mund të kenë maredhenie me të mira me të rriturit sesa bashkëmoshatarët e tyre. Ata gjithashtu mund të kenë vetëbesim më të ulët, gjë që mund të rezultojë në pakësimin e raportimit për viktimizimin nga bullizmi. Krahasuar me agresoret dhe agresore- viktimat, viktimat raportojnë nivelet më të larta të vetmisë dhe ankthit, ndërsa agresoret nivele me të ulëta. Viktimat kanë statusin social më të ulët në mesin e moshatarëve të tyre dhe agresoret atë me të lartë, megjithatë, agresor-viktimat janë grupi me i shmangur nga shokët e klasës. (8)

3. Në grupin e tretë futen **agresor-viktimat**, të cilët janë fëmijët e përfshirë në sjelljet agresive së të dyja roleve, pra, ata sillen edhe si agresorë, edhe si viktima. Ata përjetojnë pasojat dhe problemet më të mëdha në mesin e të gjithë fëmijëve të përfshirë në bullizëm, duke treguar vështirësi për përbalimin e emocioneve negative apo të rrethanave problematike e të vështira, duke i kthyer problemet nga vetja.. Por këta fëmijë shfaqin edhe sjellje problematike dhe negative, të cilat nuk i drejtohen vetes, por të tjerëve, gjë që e shfaqin nëpërmjet largimit nga shkolla, nëpërmjet sjelljeve agresive me të tjerët, nëpërmjet dëmtimit të sendeve personale të të tjerëve etj. Ata gjithashtu njihen si agresor reaktiv ose viktima provokative / agresive. Këta mund të jenë fëmijë impulsivë, të cilët reagojnë me agresivitet ndaj faktit e të qenit i bulluar, ose viktima të cilët kalojnë nga viktimizimi në sjellje bulliste gjatë një periudhe kohore. Ekziston më pak informacion rreth agresor-viktimave në krahasim me grupet e tjera, edhe pse ky grup duket se ka gamën më të rëndë dhe më të gjerë të problemeve të përshtatjes. Fëmijët në këtë grup mund të kenë probleme të përqendrimit, vetëvlerësim të ulët, dhe sidomos shkallë të lartë të depresionit. . Ata janë më shumë anksioz dhe më pak të popullor sesa agresoret, kanë aftësi të dobëta sociale dhe në zgjidhjen e problemeve, kanë tendence të fyejnë shokët dhe kështu nuk janë të pëlqyer nga shokët ose mësuesit. Ata kanë më shumë gjasa të vijnë nga familje me prindërim të dobët ose të varfër, mungesë ngrohtesie dhe mund të mësojnë sjellje agresive nga shtëpia.

I.b Format e shfaqjes së bullizmit

Sjelljet bulliste ndryshojnë në nivelin e tyre të forcës dhe mund të jenë si fizike dhe psikologjike.

Bullizmi mund të shfaqet në formën direkte dhe indirekte të agresionit.

1. Forma direkte përfshin agresionin fizik (real) dhe verbal, që përbëhen nga një shprehje e hapur e fuqisë. Bullizmi fizik përfshin çdo lloj sulmi fizik, të tilla si goditja, shtyrja, goditja, mbytja dhe marrja e dhunshme e viktimës. Bullizmi verbal përfshin ngacmime verbale ose kërcënime në formën e pseudonimeve, kërcënimit, talljes, ngacmim me qëllim të keq dhe dhunë psikologjike duke përdorur fjalë për të dëmtuar viktimat. Vjedhja, vandalizimi dhe bërja e mimikave ose gjesteve të turpshme janë gjithashtu mënyra në të cilat fëmijët bullohen

2. Forma indirekte e bullizmit përbëhet kryesisht nga agresioni relacional, i cili përfshin përjashtimin social të viktimave përmes manipulimit të marrëdhënieve shoqërore nga agresoret ose duke dëmtuar reputacionin e viktimave duke përdorur thashetheme, shpifje,

sabotim, dhe bindjes se kolegve të tjerë që të përjashtojnë viktimat nga shoqëria. Bullizmi më së shpeshti ndodh në zonat me pak mbikëqyrje të të rriturve, të tilla si vendet e lojërave dhe korridoret e shkollës. Bullizmi verbal dhe ai relacional janë më të vështira për t'u identifikuar se sa bullizmi fizik. Bullizmi relacional është më i zakonshëm midis vajzave dhe mund të çojë në ndjenjat e refuzimit në një kohë kritike në zhvillimin shoqëror. **Error! Bookmark not defined..Error! Bookmark not defined..Error! Bookmark not defined.**

Një ndarje më e qartë dhe shpjeguese mbi format e bullizmit pasqyrohet si më poshtë :

Bullizëm fizik, i cili është bullizëm që merr formën e abuzimit fizik (p.sh. grushtimi, shkelmimi, goditje të formave të ndryshme, shtytje, pështyrja, vjedhja ose shkatërrimi i sendeve a i pronës, si p.sh. vjedhje e lekëve, vjedhje ose shkatërrim i librave, i veshmbathjeve etj.). Bullizmi fizik është tipik për meshkujt, por nuk përjashtohet as tek femrat, të cilat mund të jenë viktimat e tij, por edhe pjesëmarrëse aktive, pra agresore.

Bullizëm verbal (p.sh.: sharjet, kërcënimi, përhapja e thashetheme dashakeqe, nofkat ofenduese etj.). Qëllimi i tij kryesor është degradimi i viktimës. Në shumë raste bullizmi verbal është veti e vajzave, të cilat e përdorin atë, si dhe teknikat e përjashtimeve sociale, për të sunduar të tjerët dhe për të treguar epërsinë dhe pushtetin e tyre.

Bullizëm social (p.sh., duke lënë një ose disa nxënës jashtë lojërave apo grupit bashkëmoshatar, duke i shpërfillur apo duke mos i ftuar në festat e klasës apo të shkollës, prishja e miqësisë etj.).

Bullizëm seksual (p.sh. sjellje seksuale e padëshiruar fizike ose verbale, që përfshin pohime seksuale eksplicite dashakeqe ose shënime seksualisht diskriminuese dhe kontakte të padëshirueshme fizike që bëhen nga dikush në një mjedisi edukativ që janë fyese dhe të pakëndshme për nxënësin dhe bëjnë që ai të ndjehet i turpëruar ose në siklet, ose ndërhyr në rezultatet e tij akademike etj.).

Bullizëm virtual/ kibernetik, i cili është bullizëm që ndodh nëpërmjet dërgimit të mesazheve të bezdisshme, shqetësuese dhe kërcënuese përmes telefonit apo internetit, nëpërmjet shërbimeve të rrjeteve sociale, nëpërmjet blogjeve e të tjera mjeteve të fushës kibernetike. Ai mund të bëhet edhe nëpërmjet ndërthurjes së njëkohshme të të gjitha mjeteve të sapo përmendura. Agresorët kibernetikë mund ta fshehin veten e tyre, kështu që viktimat e tyre provojnë mbi kurrizin e tyre edhe sulme anonime. Në përmbajtjen e këtij lloji bullizmi mund të futen edhe format e bullizmit emocional të ushtruar nëpërmjet kibernetikës, futen edhe thashethemet, postimi i informacioneve private, përjashtimi i dikujt nga faqja elektronike (on line), kontakti i padëshiruar kibernetik etj. Meqë interneti dhe rrjetet sociale elektronike po rriten, një gjë e tillë çon edhe në rritjen e bullizmit kibernetik.¹ Në dallim nga bullizmi tradicional, , përkufizimet e dhunës në internet nuk përfshijnë një diferencë të fuqisë midis dhunuesit dhe viktimës dhe jo të gjitha përkufizimet e bullizmit kibernetik theksojnë që sjellja është e përsëritshme. Kjo është një formë e fshehtë e bullizmit , mund të ndodhë në shkollë dhe në shtëpi, është e vështirë për t'u zbuluar dhe verifikuar, dhe arrin një audiencë të gjerë me shpejtesi dhe është lehtësisht e arritshme për mbi 80% të adoleshentëve të cilët kanë akses në teknologjinë e medias. Agresorët kibernetikë përdorin këto media duke dërguar mesazhe mizore ose kërcënuese, duke marrë përsipër llogarinë e email – it të viktimave dhe duke dërguar mesazhe të turpshme ose të pahijshme tek të tjerët që shfaqen sikur të kenë ardhur nga viktimat, duke krijuar faqet e internetit me fotografi ose tallje për viktimat dhe duke ftuar shokë të tjerë të klasës për të marrë pjesë në ngacmimin e viktimave online dhe

mashtrimin e viktimave për të zbuluar informacione të ndjeshme përmes postës elektronike ose mesazheve të menjëhershme dhe më pas duke ia përcjellë të tjerëve. (9)

I.c Shkaqet e bullizmit

- Ndjenja e pafuqisë në jetën e tyre personale

Dhuna, qoftë verbale, fizike, ose të dyja, është një mënyrë që njerëzit pretendojnë një lloj pushteti në jetën e tyre duke kërkuar që ata të duken të prekshëm dhe duke sulmuar një aspekt të personalitetit të viktimave që i bëjnë ata të reagojnë. Ky person mund të ketë këpucë të vjetra, të jetë shumë i shkurtër, shumë i zgjuar, etj. Arsyeja nuk ka rëndësi.. Ndonjëherë ndjenja e pafuqisë vijnë nga një problem në shtëpi. Për fëmijët, kjo mund të jetë një situatë e tillë si zenkat e shumta në shtëpi, prindërit e divorcuar ose ndonjë pjesëtar i familjes që është vares ndaj drogës ose alkoolit.

- Dikush tjetër po i sulmon ata

Në shumë raste, bullizmi në vetvete shkakton bullizem. Një person mund të ndihet i keqtrajtuar nga prindërit e tyre, shefi i tyre ose një vëlla/ moter më i/e madhe. Pra nëse një individ që bullohet nga një / disa persona që kanë autoritet me të lartë sesa ata mund t'i tundojë ata që të kërkojnë një lloj autoriteti për veten e tyre përmes bullizmit në vend që të arrijnë të ndihmojnë në trajtimin e çështjeve të tyre në një mënyrë më produktive.

- Agresoret janë shpesh xhelozë ose të frustruar me personin që po ngacmojnë

Një target i lehtë për agresoret mund të jetë dikush i cili është gjithmone i pari për zgjedhin si objektiv dike që ngre dorën gjithmone në mesim, merr piket me të larta në teste etj.

Disa nga gjërat që i bëjnë njerëzit të ndryshëm nga njeri tjetri në përgjithësi janë karakteristika neutrale, por disa, si të qenit i zgjuar, i përqendruar ose krijues, shpesh përfaqësojnë atributet që ata dëshirojnë që t'i ndajnë me viktimën e tyre. Duke kërkuar për të dëmtuar aftësitë e dikujt tjetër, agresoret të përpiqen të krijojnë një fushë më të barabartë të lojës.

- Mungesa e Mirëkuptimit ose Empatise

Në disa raste një person mund të bullojë sepse ka një aspekt të personalitetit të viktimes që nuk e kupton ose nuk e pranon. Ata gjithashtu mund të jenë paragjykes ndaj racës, fesë ose orientimit seksual të personit në fjalë, dhe në shumë raste mund të mendojnë se zgjedhja e këtij personi target është një gjë e mirë pasi sjelljen/ tiparin e tyre e shohin si dicka të keqe. Error! Bookmark not defined.

- Kerkojnë vëmendje

Disa agresorë nuk e mendojnë veten e tyre si të tillë. Ata mendojnë se gjithçka që po bëjnë është thjesht ngacmim dhe madje mund të jenë duke u përpjekur të komunikojnë ose madje të shoqërohen me personin që po "bullojnë".

Socializimi i bëjnë ata të kenë probleme me komunikimin në mënyrë të shëndetshme dhe në vend të kësaj të kthehen në ofendime apo edhe dhunë fizike si një mënyrë për të komunikuar. Shumë herë, agresoret në të vërtetë janë njerëz shumë të vetmuar që nuk kanë shumë miq të vërtetë dhe duan të tërheqin çfarëdo lloj vëmendje që mundën.

Një person i bulluar pra viktimë mund të jetë në gjendje të zvogëlojë rastet e bullizmit dhe madje të behet mik me kundërshtarin, pavarësisht se si trajtohet. Duke i dhënë

vëmendje pozitive atij para se ata të kenë mundësinë të kërkojnë vëmendje negative, duke i bere keshtu gjërat më mirë për veten e tyre dhe agresoret

I.d Pasojat e bullizmit

Bullizmi në shkollë është lloji më i zakonshëm i dhunës në shkollë dhe është një burim kryesor i viktimizimit midis fëmijëve dhe adoleshentëve. Ai lidhet me sjellje më të rënda të dhunshme dhe mund të ketë pasoja në sjelljet shendetsore .

Viktimizimi për shkak të bullizmit në shkollë shoqërohet me probleme të sjelljes emocionale dhe sociale. Gjithashtu bullizmi mund të çojë në probleme të rënda mendore dhe fizike (10)

Fëmijët e viktimizuar kanë një probabilitet më të lartë të zhvillimit të problemeve klinike, siç janë urinimi në krevat , probleme me gjumin , ankth, depresion, fobi nga shkolla , ndjenjat e pasigurisë dhe pakënaqësia në shkollë. Ata gjithashtu mund të vuajnë nga vetëbesimi i ulët, vetmia, izolimi dhe simptomat somatike.

Është e rëndësishme që fëmijët në rrezik në rritje të viktimizimit të identifikohen herët për të lehtësuar parandalimin në kohë nga viktimizimi i bullizmit . Aftësia për të identifikuar fëmijë të tillë rritet me njohjen e determinantëve dhe parashikuesve të sjelljes së bullizmit . Modelet e viktimizimit të bullizmit mund të ndryshojnë sipas gjinisë dhe moshës, dhe këto dallime mund të pasqyrojnë proceset zhvillimore të lidhura me moshën dhe gjininë. (6)

Nga rezultatet është e qartë se bullizmi në çfarëdo forme qofte ai ka efekte të qëndrueshme negative në zhvillimin e një personi. Te ekspozuar nga keto efekte nuk eshte vetëm viktimja, por edhe bullues - i , simptomat për të dy do të variojnë nga efektet afatshkurtra në ato të afatgjata, të rënda dhe nga te cilat varet jeta e tyre. (5)

Ky fenomen mund t'i çojë nxenesit , të komprometojnë procesin mësimor dhe të ndikojnë në mënyrën se si individët i përgjigjen kërkesave sociale gjatë jetës së tyre. Këto pasoja negative, për të gjithë ata që përfshihen dhe që shoqërohen me përhapjen dhe frekuencën në rritje me të cilën ndodh bullizmi , e shndërruan bullizmin në një problem të rëndë publik në mbarë botën.

I.e Faktorët që ndikojnë në sjelljet bulliste

Faktorët protektiv në fenomenin e bullizmit (10)

- Përfshirja e prindërve me femijen
- Modele pozitive të rriturve
- Mbështetje e lartë prindërore
- Jetesa në një familje me dy prindër
- Ngrohësia e nënes

Faktorët riskante në zhvillimin e bullizmit (5)

- Moshë e re e fëmijës
- Gjinia mashkullore
- Depresioni , probleme të shëndetit mendor, ose emocionale /problemet zhvillimore / të sjelljes
- Arritje të ulëta akademike
- Përdorimi i substancave
- Ekspozimi ndaj abuzimit dhe dhunës në familje
- Ndeshkimi fizik nga prinderit

- Komunikimi i dobët prind-fëmijë
- Mungesa e monitorimit prindëror
- Konflikte familjare në nivele të larta
- Marrëdhënie të dobëta me shokët e klasës
- Influence negative nga bashkemoshataret e tyre
- Jetesa në një lagje të pasigurtë

Gjinia dhe bullizmi

Kjo kategori na mundëson të kuptojmë rolet e paracaktuara shoqërore për burrat dhe gratë si autorë të marrëdhënieve hierarkike të pabarabarta. Literatura shkencore jep rezultate në këtë drejtim, duke theksuar çështjet e gjinisë në analizat e bullizmit në shkollë. Hulumtimet mbi bullizmin sugjerojnë se djemtë janë më të prirur për të qenë si agresor dhe viktimë të bullizmit, veçanërisht nënë atë fizik, pasi vajzat kanë më shumë gjasa të angazhohen në situata të bullizmit indirekt të tilla si ngacmim ose thashetheme për shokët.

1.f Mënyrat e parandalimit të bullizmit në shkollë

Një thënie famshme sugjeron se “fëmijët janë fëmijë” dhe ngacmimi është pjesë normale e rritjes së tyre.

Por, ngacmimet e vazhdueshme përmes teknologjisë, kërcënimet me vdekje apo agresionet, duke e shndërruar fenomenin e bullizmit në epidemi që rrezikon jetën e adoleshentëve. Shumica e fëmijëve e kanë shumë të vështirë të largohen nga sjellje apo kërcënime të tilla, duke rritur kështu ndjeshëm numrin e vetëvrasjeve. Në këto kohë, të gjitha institucionet arsimore janë duke u shtrydhur dhe shtrënguar të gjejnë zgjidhje efikase kundër bullizmit, duke përfshirë prindrit, mediat, politikën si dhe vetë mësuesit. Sipas studimit të realizuar nga Mahoney në vitin 2012, rreth bullizmit dhe viktimave të tij, rezultoi se 1 në 10 viktimë bullizohet çdo ditë, ndërsa 1 në 5 viktimë bullizohet 1-2 herë në muaj. Asnjë episode bullizmi nuk mund të parashikohet, prandaj asnjë incident nuk mund të evidentohet në kohë. Pra, të gjitha shkollat gjenden përpara një sfide, me qëllim parandalimin e episodeve të bullizmit apo të dhunës që shoqërojnë shpesh këto incidente.

Më poshtë janë paraqitur disa mënyra se si bullizmi mund të parandalohet në institucionet e edukimit:

1. Të qartësohet përkufizimi i bullizmit.

a. Bullizmi ndodh në të gjitha klasat, nivelet apo moshat. E gjithë shkolla në tërësi, ka nevojë të përdor të njëjtën gjuhë për të parandaluar këtë fenomen, duke nisur që nga krijimi i një përkufizimi të qartë dhe të përbashkët të bullizmit. Sipas një përkufizimi në vitin 2011, bullizmi përcaktohet si sjellje agresive e qëllimshme, e manifestuar nëpërmjet formave fizike, verbale dhe joverbale. Është fenomen i përsëritur, edhe pse mësuesi mund ta vëjë re për herë të parë, prandaj është shumë e rëndësishme të bisedohet me viktimën për të evidentuar rastet e

b. Staf i mësuesor duhet të jetë në gjendje të dallojë ngacmimin nga bullizmi. Ngacmimi është më frekuent se bullizmi, madje ai ndodh me qëllim për të irrituar apo provokuar dikë, duke e shpërqëndruar apo duke e besdisur, ndërsa bullizmi është një çekuilibër i fuqisë. Viktimat e bullizmit janë të paafte të mbrojnë veten ose shihen si të tillë, fakt i cili përbën në vetvete çekuilibrin e fuqisë.

c. Bullizmi kibernetik. Në format e bullizmit, sikurse është përmendur edhe më sipër, duhet të përfshihen edhe format e bullizmit kibernetik, si mesazhet në mediat

sociale, video, email, tekste, etj. Prandaj, I gjithë stafi akademik duhet të njoh përmes trajnimeve se çfarë është bullizmi, cilat janë politikat dhe rregullat e shkollës dhe se si mund të përforëcohen ato.

2. **Hiq etiketat dhe adresojë sjelljet.** Kur mësuesit dhe stafi e quajnë një fëmijë bullist apo viktimë, ata janë duke vendosur një gjykim mbi atë fëmijë, I cili mund të shkaktojë problem në të ardhmen tek ky student. Gjatë vlerësimit të sjelljeve të studentit apo fëmijës, stafi nuk duhet të jetë gjykues. Si fillim duhet të qartësohet situata dhe të gjendet se çfarë ka ndodhur, për të vendosur nëse incidenti I ndodhur është bullizëm apo jo. Në cdo situatë duhet marrë parasysh që secili prej studentëve vjen nga rrethana të ndryshme, ka bagazhin dhe intelektin e vetë dhe ka një arsye që e shtyn të sillen në atë mënyrë. Për të zgjidhur problemin, duhet të përfshihet edhe studentit bullist, pasi I duhet të jetë në dijeni se çfarë janë duke shkaktuar sjelljet e tij tek personi tjetër. Student bullist duhet të qartësohet mbi sjelljet e gabuara, pse janë të gabuara dhe çfarë mund të shkaktojnë ato. Nëse sjellje përsëritet atëherë në process duhet të përfshihen edhe prindrit. Shumë studime kanë treguar se prindrit të cilët janë përfshirë në procese të tilla kanë deklaruar se fëmija I tyre(I cili ka manifestuar sjellje bullizmi) është shprehur se ka qënë viktimë e ngacmimit dhe bullizmit. Në këto situata, janë kuptuar sjelljet e vërteta të fëmijëve ose perceptimet e tyre për situatat e ndodhura.

3. **Duhet të vendosen dhe të imponohen rregulla dhe pritshmëri të qarta.** Rregullat e vendosura duhet të jenë në përputhje me moshën e nxënësit. Vendosja e rregullave I lejon nxënësit të njohin se si duhet të sillen, se cilat janë sjelljet e përshtatshme për ta. Nëse nxënësit janë të vegjël, duhen vendosur rregulla të thjeshta, ndërsa për fëmijë më të rritur rregullat duhet të formohen më nyrë të tillë që ata të arrijnë pjekurinë e tyre. Sipas Scheuermann and Hall personeli duhet të:

- a. Të vendosen rregulla duke përdorur terma pozitiv.
- b. Të vendosen sa më pak rregulla
- c. Të vendosen rregulla të cilat mbulojnë situata multiple
- d. Sigurohuni që rregullat janë në përputhje me moshën
- e. Vendosni një shembull zbatimi
- f. Qëndroni konsistentë në sbatimin e tyre dhe mos bëni tolerime.

Thyerja e rregullave duhet të jetë shumë e qartë. Studentët duhet të dinë se çfarë do të ndodh nëse ata përfshihen në sjellje të caktuara. Kjo strategji siguron pritshmëri të qarta.

4. **Sjelljet positive duhet të shpërblehen.** Sipas Departamentit të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore në USA, cdo mësues apo staf akademik duhet të afirmojë sjellje të mira, 1-5 herë që kritikon një sjellje të keqe. Asnjëherë fëmijët nuk duhet të qortohen publikisht, por në veçanti. Studentët duhet të ndihmohen të korrigjojnë sjelljet e tyre dhe të kuptojnë se shkelja e rregullave sjell pasoja. Trajtimi pozitiv I studentëve dhe krijimi I një fryme positive I ndihmon ata të behën më të pranueshëm, më tolerantë dhe pozitivë.

5. **Krijoni një komunikim të hapur.** Nëse mësuesit do të krijojnë një komunikim të hapur më studentët e tyre atëherë kta të fundit do të ndihen të sigurtë të flasin për problemet e tyre, përfshirë këtu dhe bullizmin. Krijimi I mbledhjeve në klasë ku të bashkëbisedohet për çështje të ndryshme, I ndihmon mësuesit dhe prindrit të informohen rreth asaj cka ndodh në klasë mes nxënësish. Nxënësi duhet të jetë I sigurtë që mësuesi do ta dëgjojë atë, duhet të ndihet I mirëpritur të flas jo në publik dhe të mund të bisedojë rreth bullizmit. Gjithashtu shkollat duhet të kenë një sistem raportimi, ku stafi dhe mësuesiot duhet të raportojnë incidentet që mund të ndodhin. Duke përdorur këto sisteme, nxënësit mund të mbrohen dhe të parandalohen situata apo incidente të tilla më tej. Përdorimi I këtij sistemi duhet të jetë sa më I lehtë ndaj nxënësve, gjithashtu konfidencial, në mënyrë që të inkurajohet përdorimi I tij. Duke patur parasysh që

komunikimi nuk është vecse verbal, I gjithë institucioni edukues duhet të përdor mënyra joverbale komunikimi positive, nisur që nga pamja e brendshme apo e jashtme si dhe dekorimet të cilat duhet të përcjellin një mesazh pozitiv tek studentët. Nëse gjithë pamja e shkollës nuk përcjell një mesazh pozitiv, atëherë sjelljet bulliste mund të jenë më frekvente.

6. **Përfshirja e prindërve.** duke patur parasysh që në jetën e një fëmije marrin pjesë shumë aktorë, që nga prindrit, mësuesit, e shumë të afërm, etj, është shumë e rëndësishme që midis stafit mësuesor dhe prindërve të krijohet një raport I cili do të ketë vetëm benefite tek nxënësi. Mësuesit duhet të raportojnë sjelljet e fëmijës tek prindërit si dhe të marrin informacion rreth sjelljes së tyre në shtëpi.

7. **Shikoni për shenja paralajmëruese.** Nëse një incident bullizmi ka ndodhur atëherë duhet parë për shenja paralajmëruese. Mësuesit nuk I shikojnë të gjitha shenjat, prandaj duhet të përfshihen edhe studentë të tjerë apo prindrit. Duhet patur parasysh shenjat në rastin e viktimave të bullizmit:

- a. Dëmtime të papritura të fëmijës
- b. Dhimbje e shpeshtë koke apo stomaku
- c. Ndryshime në ushqyerje
- d. Crregullime të gjumit
- e. Ngelje të klasë
- f. Humbje e interes ndaj shkollës
- g. Humbje e miqve
- h. Shkatërrim I sendeve personale
- i. Ulje e vetëbesimit

Në rastin e nxënësve bullist, duhen patur parasysh shenjat e mëposhtme:

- a. Studenti merr pjesë në shumë grindje ose ka shok persona bullist
- b. Nxënësi bëhet shpesh herë agresiv
- c. Fajëson të tjerët për problemet e tij, refuzon të pranojë përgjegjësinë për veprimet e tij, është shumë I shqetësuar për popullaritetin dhe reputacionin.

8. **Nëse ka ndodhur një incident duhet qartësuar skena.** Situata nuk duhet gjykuar ashtu sikurse duket. Nxënësit duhet të pyeten vecmas në mënyrë që të grumbullohen sa më shumë fakte. Situat duhet qartësuar dhe rregulluar, kryesisht midis fëmijës viktimë dhe atij bullist. Si fillim duhet të evidentohet grupi përkrahës I fëmijës bullist, më pas të intervistohen një-nga-një për të marrë fakte. Duhet patur parasysh që bullizmi nuk merr fund me këtë incident, prandaj duhet qartësuar situata për ti dhënë fund këtyre sjelljeve.

9. **Të monitorohen pikat e nxëhta.** Zakonisht incidentët ndodhin në mjedise të caktuara si holl I shkollës, tualete, oborr e pasme të shkollave, etj. Duhet të monitorohen të gjitha këto mjedise, nisur që nga klasat, për të patur fakte vizuale dhe vokale por dhe për të parandaluar në moment incidentët.

10. **Të afishohen ligjet e rregullat e vendit.** Të gjithë nxënësit kanë të drejtë të mbrojtur me ligj të arsimohen në mjedise të sigurta për ta. Stafit dhe vetë vetë nxënësit duhet të jenë në dijeni të legjislacionit të arsimit si dhe të drejtave të tyre.

II. Metodologjia e punimit

Qëllimi I këtij punimi është vlerësimi I fenomenit të bullizmit, viktimizimit si dhe sjelljeve agresive, në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Vlorës.

II.a Objektivat e punimit.

Objektivat mbi të cilat është mbështetur zhvillimi i këtij punimi janë si më poshtë:

- ❖ Shqyrtimi i literaturës bashkëkohore për të evidentuar studime të ngjashme të cilat do të merren në konsideratë ose do të shërbejnë si shtylla orientimi në këtë punim.
- ❖ Shpërndarja e pyetësorit dhe plotësimi i plotë i tij, mungesa e të dhënave nuk është e favorshme
- ❖ Vlerësimi i tre fenomeneve që mat Illinois Bully Scale (IBS), konkretisht matja e fenomenit të bullizmit, viktimizimit dhe grindjeve apo agresionit fizik.
- ❖ Të vlerësojmë se cili prej këtyre fenomeneve është më dominant në sjelljet e nxënësve.
- ❖ Të vlerësojmë se si ndikon mbarëvajtja mësimore në këto sjellje dhe nasjelltas, pra a ndikojnë këto sjellje në ecurinë mësimore të nxënësve të intervistuar.
- ❖ Të vlerësojmë nëse bullizmi është manifestohet më shumë tek femrat apo tek meshkujt.
- ❖ Të vlerësojmë marrëdhëniet midis sjelljeve bulliste, viktimizimit dhe grindjeve fizike, për të përcaktuar se si ndikojnë ato tek njëra tjetra.
- ❖ Të krahasojmë rezultatet e këtij punimi me studime bashkëkohore.
- ❖ Të ofrojmë rekomandimet e nevojshme bazuar në gjetjet e këtij punimi.

II.b Mostra e marrë në studim

Duke qënë se ky punim ka për qëllim vlerësimin e bullizmit në shkollat 9-vjeçare, atëherë janë intervistuar nxënës së klasës së 5-të, 6-të, 7-të, 8-të dhe të 9-të, në shkollat, “Avni Rustemi”, “Muco Delo”, “Perla”, “Elite” dhe “Lef Sallata”. Edhe pse synimi fillestar ka qënë që në studim të përfshiheshin të gjithë shkollat 9-vjeçare të qytetit, vetëm 5 shkolla kanë bashkëpunuar dhe janë treguar të gatshme edhe pse ka patur një leje të vecantë të mundësuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale, Vlorë, për zhvillimin e këtij pyetësori. Janë marrë të plotësuar tërësisht pyetësorët e N=475 nxënësve në total.

II.c Instrumenti i përdorur për të mbledhur të dhënat

Të dhënat e këtij punimi janë mbledhur nëpërmjet pyetësorëve të vetëadministruar. Në këtë punim është përdorur pyetësori i standartizuar, Illinois Bully scale (IBS), i cili është përshtatur në gjuhën tonë dhe u është shpërndarë nxënësve. Çdo e dhënë e grumbulluar në këtë pyetësor është vetë-deklarim i nxënësit, pra nuk mund të gjykojmë nëse nxënësi ka bërë një rrëfim të sinqertë apo jo.

Fillimisht në këtë pyetësor merren të dhëna të përgjithshme të nxënësit, nisur nga gjinia, mosha, klasa vendbanimi, etj. Gjithshtu është marrë informacion mbi peshën dhe gjatësinë e nxënësit, duke menduar se këto mund të jenë variabla të cilat ndikojnë mbi sjelljet bulliste. Po ashtu janë pyetur nxënësit rreth mbarëvajtjes së tyre mësimore, për të parë se si mund të ndikojnë këto sjellje në ecurinë mësimore I dhe anasjelltas.

Pjesa tjetër e pyetësorit përmban 18 pyetje në total, të cilat masin tre sjellje kryesore të nxënësve, bullizmin, viktimizimin si dhe sjelljet agresive.

Fenomeni i bullizmit matet me pyetjet nr. 01, 02, 08, 09, 14, 15, 16, 17, dhe 18, ku secila pyetje ka 5 mundësi përgjigjesh, konkretisht:

- Kurrë (kodohet 0)
- 1-2 herë (kodohet 1)

- 3-4 herë (kodohet 2)
- 5-6 herë (kodohet 3)
- Më shumë se 7 herë (kodohet 4)

Pra, pikët e grumbulluara në këtë fenomen janë nga 0 në 36 pikë, të cilat nënkategorizohen si më poshtë:

- Aspak I përfshirë→0 pikë
- Lehtësisht I përfshirë ose manifeston sjellje të lehta bullismi→1-9 pikë
- Mesatarisht I përfshirë→10-18 pikë
- Manifeston sjellje shumë të rëndë bullismi ose shumë I përfshirë në sjellje të tilla→19-36 pikë.

Fenomeni I viktimizimit matet me pyetjet nr. 04, 05, 06, 07, ku secila ka 5 mundësi përgjigjesh, sikurse pyetjet më lartë. Totali I pikëve që grumbullohen në këtë nënndarje janë 0- 16 pikë, të cilat nënkategorizohen si më poshtë vijon:

- Aspak I përfshirë→0 pikë
- Lehtësisht I përfshirë →1-4 pikë
- Mesatarisht I përfshirë→5-8 pikë
- Shumë I përfshirë→9-16 pikë.

Grindjet fizike ose agresioni vlerësohet me pyetjet nr. 03, 10, 11, 12, 13, të cilat gjithashtu kanë 5 mundësi përgjigjesh. Totali I pikëve që mund të grumbullohen në këtë çështje janë 0 pikë minimale deri në 20 pikë maximale, të cilat ndahen si më poshtë:

- Aspak I përfshirë→0 pikë
- Lehtësisht I përfshirë ose manifeston sjellje të lehta agresive →1-5 pikë
- Mesatarisht I përfshirë→6-11 pikë
- Shumë I përfshirë→12-20 pikë.

II.d Lloji I të dhënave dhe mënyra e mbledhjes

Të dhënat në këtë punim janë parësore dhe dytësore, cilësore dhe sasiore. Të dhënat e përdorura në kuadrin teorik janë të natyrës dytësore dhe cilësore, ndërsa të dhënat e përfutuara nga realizimi I pyetësorve janë të tipit parësor. Të dhëna sasiore janë të dhëna të cilat janë përfutuar nga përpunimi statistikor. Si fillim janë grumbulluar të dhënat dytësore të shpalosura gjatë kuadrit teorik, të cilat janë marrë nga publikime bashkëkohore apo literatura të cilat sqarojnë bullismin në shkollat 9-vjeçare. Pas shpërndarjes dhe mbledhjes së pyetësorëve, të dhënat janë koduar dhe përpunuar statistikisht. Plotësimi I pyetësorve është realizuar në shkollat 9-vjeçare të sipërpërmendura. Pyetësorët janë shpërndarë në mënyrë individuale, gjatë pushimit të orëve. Është siguruar që në bankë të ulej vetëm njëri prej nxënësve, në mënyrë që mos të ndikonin dhe të kushtëzonin përgjigjet e njëri tjetrit. Gjithashtu mbledhja e testeve është bërë larg vëzhgimit të mësuesëve në klasa, pasi u pa se shumë nxënës nuk dëshironin që përgjigjet e tyre të lexoheshin. Është kushtuar rëndësi në plotësimin tërësor të pyetësorit, pa patur mungesë të dhënash, duke përjashtuar këtu peshën dhe gjatësinë, të cilat u është kërkuar nxënësve të plotësohen me kujdes dhe në rastet kur nxënësit nuk e kishin të sigurtë, vlerat e tyre të liheshin bosh.

II.e Përpunimi I të dhënave

Përpunimi I të dhënave është realizuar nëpërmjet programit të përpunimit të të dhënave SPSS, version 22. Testet e përdorura janë në varësi të llojit të variablave. Për të përcaktuar vlerën e sinjifikancës është realizuar chi-square test. Gjithashtu për vlerësimin e

marrëdhënieve midis variablave janë realizuar korrelacionet midis tyre. Për të vlerësuar se cili prej fenomeneve ishte më dominant, është përlogaritur mesatarja e secilit prej tyre. Janë bërë shpërndarje të bullizmit, viktimizimit apo agresionit, sipas moshës apo klasave. Për të gjitha variablat në tërësi janë llogaritur frekuencat dhe janë paraqitur të dhënat grafikisht.

II.f Vlefshmëria e të dhënave

Në tabelat më poshtë janë paraqitur koeficientët Cronbach Alpha për secilën nga nënshkallët e pyetësorit të realizuar. Sikurse shihet konsistenca e brendshme e tre dimensioneve të matura është në vlerat e lejuara, pra $0.7 < \alpha < 0.8$,

Cronbach's Alpha	N of Items
.772	9

Tabela 1 Cronbach alpha per Bullismin

Cronbach's Alpha	N of Items
.759	4

Tabela 2 Cronbach alpha per Viktimizimin

Cronbach's Alpha	N of Items
.791	5

Tabela 3 Cronbach alpha per Grindjet fizike

II.g Kufizime të punimit

Një nga kufizimet e këtij punimi është mospërfshirja e shkollave në zonat rurale në studim. Për të patur një studim më gjithëpërfshirës, në të cilin të mund të bëhen krahasime midis llojit të shkollës apo zonave. Gjithashtu në këtë punim nuk janë vlerësuar forma të tjera të bullizmit apo faktorët ndikues në sjellje të tilla, gjithashtu në këtë pyetësor nuk merret informacion mbi gjendjen psikologjike, somatike, shëndetsore të fëmijëve, për të vlerësuar nëse këto fenomene kanë ndikuar në shëndetin e tyre.

II.h Hipotezat e punimit

Hipotezat e punimit do të analizohen pas përfundimit të përpunimit të të dhënave dhe nxjerrjes së rezultateve.

Hipoteza 1 “Meshkujt janë më agresiv se sa femrat”

Hipoteza 2 “Nxënësit manifestojnë më shumë sjellje bulliste sesa viktimizohen”

Hipoteza 3 “Nxënësit të cilët manifestojnë sjellje bulliste kanë ecuri të keqe mësimore”

Hipoteza 4 “Sjelljet bulliste nxisin sjelljet agresive”

Hipoteza 5 “Femrat viktimizohen më shumë se sa meshkujt”

II.i Etika e studimit

Sikurse u përmend edhe më sipër, është marrë një leje e veçantë në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Vlorë, për realizimin e pyetësorit në klasat e përzgjedhura. Nxënësit kanë bashkëpunuar vullnetarisht në këtë punim, duke plotësuar pyetësorët me dëshirën e tyre të lirë. Nuk është rregjistruar asnjë emër nxënësi, pasi pyetësori ka qënë anonim. Janë vlerësuar përgjigjet e tyre, të cilat nuk janë komentuar apo nuk janë bërë publike.

III. Analizimi I të dhënave të punimit


Në këtë pjesë të punimit janë analizuar të gjitha të dhënat e grumbulluara nga realizimi I pyetësorve, drejtuar nxënësve të shkollave 9-vjeçare, në qytetin e Vlorës. Sikurse është përmendur edhe në kapitullin e metodologjisë, përpunimi I këtyre të dhënave është realizuar nëpërmjet Programit të Përpunimit të të dhënave për shkencat sociale, SPSS, version 22. Për përpunimin e këtyre të dhënave është përdorur analiza descriptive, e cila na jep një paraqitje të frekuencave si dhe shpërndarjen e variablave sipas llojit të tyre. Për vlerësimin e marrëdhënieve midis variablave është përcaktuar koeficienti Pearson. Të dhënat janë paraqitur në tabela descriptive si dhe grafikisht, duke përdorur grafikë të tipit Pie apo Bar.

a. Analizimi I të dhënave të përgjithshme të nxënësve të anketuar

- Nëse shohim në tabelën e mëposhtme, 475 nxënësit e anketuar u përkasin shkollave 9-vjeçare si më poshtë:
 - Përafërsisht 18% (84 raste) janë nxënës në shkollën “Avni Rustemi”
 - 26%(123 raste) e të intervistuarve janë nxënës të cilët studiojnë në shkollën “Muco Delo”
 - Vetëm 5.5% (26 raste) janë nxënës të shkollës “Perla”
 - Shumica e të intervistuarve, rreth 27% (128 raste) janë nxënës të shkollës jopublike “Elite”
 - 24% (114 raste) janë nxënës të shkollës “Lef Sallata”

Shkolla	Frekuenca	Pwrqindja
Avni Rustemi	84	18%
Muco Delo	123	26%
Perla	26	5%
Elite	128	27%
Lef Sallata	114	24%
Total	475	100%

Tabela 4 Numri i nxënësve të anketuar sipas shkolla ku studiojnë




Grafiku 1 Numri i nxënësve të anketuar sipas shkolla ku studiojnë

2. **Gjinia e nxënësve të anketuar.** Nëse shohim në tabelën e mëposhtme, shumica e nxënësve të intervistuar janë femra, në një përqindje prej 52% (249 raste), ndërsa meshkuj janë përafërsisht 48% (226 raste). Të dhënat paraqiten numerikisht dhe grafikisht si më poshtë.

Gjinia e nxenesve te anketuar			
	Frekuenca	%	% vlefshme
Femer	249	52.4	52.4
Mashkull	226	47.6	47.6
Total	475	100.0	100.0

Tabela 5 Gjinia e nxënësve të anketuar



Grafiku 2 Gjinia e nxënësve të anketuar

3. **Mosha e nxënësve të intervistuar.** Në këtë punim janë marrë nxënës të shkollave 9- vjecare, konkretisht nxënës nga klasa e 5-të deri në atë të 9-të, mosha e të cilevë paraqitet si më poshtë, sëbashku me frekuencat e tyre. Sikurse shihet, shumica e të intervistuarve, 24%, I përket moshës 14-vjecare, ndjekur nga 12 vjecarët me 19%, e kështu me rradhë të gjitha moshat, nga 10 vjeç në 19 vjeç.

Mosha			
	frekuenca	%	% vlefshme
10	19	4.0	4.0
11	76	16.0	16.0
12	91	19.2	19.2
13	71	14.9	14.9
14	114	24.0	24.0
15	88	18.5	18.5
16	12	2.5	2.5
17	1	.2	.2
18	1	.2	.2
Total	475	100.0	100.0

Tabela 6 Mosha e të intervistuarve

4. **Klasa e të anketuarve.** Shumica e nxënësve të anketuar I përkasin klasës së 9-të, me 25% (120 raste), ndjekur nga klasa e 6-të, me 21% (100 raste), të dhënat janë paraqitur si më poshtë në tabelën nr. 4.

Klasa			
	Frekuenca	%	% vlefshme
4	2	.4	.4
5	80	16.8	16.8
6	100	21.1	21.1
7	74	15.6	15.6
8	99	20.8	20.8
9	120	25.3	25.3
Total	475	100.0	100.0

Tabela 7 Klasa e të anketuarve

5. **Vendbanimi.** Përsa I përket vendbanimit të nxënësve të intervistuar, shumica e tyre, 66%, shprehen se jetojnë në qendër të qytetit, ndjekur nga 27% e tyre, të cilët jetojnë në periferi dhe vetëm 35% e nxënësve shprehen se jetojnë në një fshat apo qytet tjetër dhe studiojnë në shkollat e sipërpërmendura.

Vendbanimi					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Periferi	127	26.7	26.7	26.7
	Qender e qytetit	313	65.9	65.9	92.6
	Fshat/qytet tjetër	35	7.4	7.4	100.0
	Total	475	100.0	100.0	

Tabela 8 Vendbanimi i nxënësve të intervistuar

6. **Pesha e të intervistuarve dhe BMI.** Në këtë pikë të pyetësorit, nxënësit janë pyetur rreth peshës së tyre. Nëse shohim tabelën e mëposhtme, 11 raste nuk kanë deklaruar peshën e tyre, cka nënkupton se këta nxënës nuk janë në dijeni të saj. Të gjitha shënimet e tjera mbi peshën e tyre varen nga vetë deklarimi I këtyre nxënësve, pra nuk mund të gjykojmë nëse pesha e dhënë prej tyre është realisht pesha që kanë këta nxënës. Në tabelën e mëposhtme bëhet një paraqitje e mesatares së peshës së nxënësve të intervistuar, në bazë të moshës së tyre. Gjithashtu në tabelat që vijojnë më tej është bërë një llogaritje e BMI (Body Mass Index) për të gjitha rastet që kanë deklaruar të dhënat e tyre mbi peshën dhe gjatësinë. Mesatarja e BMI për rastet e intervistuar është 19.55, me Dev. Stan=5.02. Të dhënat mbi BMI të llogaritur janë paraqitur dhe në histogramën e mëposhtme. Për llogaritjen e BMI janë shqyrtuar 453 raste, nga 475 raste në total, cka do të thotë që 22 raste kanë mungesë të dhënash (peshë ose gjatësi, pa të cilat nuk mund të zbatohet formula e llogaritjes së BMI).

Shpërndarja e mesatares se peshes sipas moshes se nxenesve te anketuar			
Pesha		mesatarja	N
Mosha			
10 vjec		35.26	19
11		41.95	75
12		45.29	91
13		48.24	67
14		52.83	111
15		57.22	86
16		64.92	12
17		77.00	1
18		78.00	1
19		89.00	1
mungese te dhenash			11


Tabela 9 Mesatarja e peshes sipas moshes se nxenesve

Extreme Values

			Case Number	Value
BMI	Highest	1	329	101.01
		2	75	34.91
		3	266	32.27
		4	445	29.86
		5	68	29.14
	Lowest	1	404	11.43
		2	40	12.65
		3	157	12.66
		4	5	12.82
		5	430	13.76

Tabela 10 Vlerat ekstreme te BMI

Histogram



Grafiku 3 BMI e nxënësve të intervistuar

Descriptives

		Statistic	Std. Error	
BMI	Mean	19.5460	.23588	
	95% Confidence Interval for Mean	Lower Bound	19.0824	
		Upper Bound	20.0095	
	5% Trimmed Mean	19.2266		
	Median	18.9020		
	Variance	25.204		
	Std. Deviation	5.02035		
	Minimum	11.43		
Maximum	101.01			

Tabela 11 Mesatarja e BMI

7. **Gjatësia e nxënësve të intervistuar.** Nëse shohim tabelën më poshtë, është bërë një shpërndarje e mesatares së gjatësive sipas moshës së nxënësve. Shohim se 17 raste nuk kanë dhënë informacion mbi gjatësinë e tyre.

Shpërndarja e gjatësive mesatare sipas moshës së nxënësve të anketuar

Gjatësia			
Mosha	Mesatarja	N	
10	144.79	19	
11	150.06	70	
12	155.41	91	
13	157.71	68	
14	163.16	109	
15	167.69	86	
16	173.67	12	
17	175.00	1	
18	180.00	1	
19	190.00	1	
Mungese të dhenash		17	

Tabela 12 Mesatarja e gjatësive sipas moshës së nxënësve të anketuar


8. **Mbarëvajtja mësimore.** Duke marrë në konsideratë studime të tjera rreth fenomenit të bullizmit, është marrë informacion rreth ecurisë në mësim, duke menduar që kjo është një variabël e cila ndikon në sjelljen e nxënësve nëpër shkollë. Sikurse të gjitha variablat e tjera, edhe kjo variabël është një vetëdeklarim i nxënësve. Rreth 30% e tyre shprehen se kanë një ecuri “të mirë” në shkollë, shumica e nxënësve, 51.4% e tyre, shprehen se kanë një ecuri “shumë të mirë”, 14% shprehen se kanë një ecuri mesatare dhe shumë pak raste, vetëm 1.5% dhe 2% shprehen se janë “keq” ose “shumë keq” në mësim.

Mbarëvajtja mësimore e nxënësve të anketuar

	Frekuenca	%	% vlefshme	% kumulative
Mire	142	29.9	30.2	30.2
Shume mire	244	51.4	51.9	82.1
As mire as keq	68	14.3	14.5	96.6
Keq	7	1.5	1.5	98.1
Shume keq	9	1.9	1.9	100.0
Total	470	98.9	100.0	
Nuk ka të dhena	System	5	1.1	
Total		475	100.0	

Tabela 13 Mbarëvajtja mësimore

Të dhënat e mësipërme janë paraqitur grafikisht në grafikun e mëposhtëm të tipit Bar. Vlerësimi i marrëdhënies midis ecurisë në mësim dhe variablave të tjera do të realizohet në vazhdim.




Grafiku 4 Mbarëvajtja mësimore

b. Fenomeni I viktimizimit.

9. Sikurse është përmendur edhe në kapitullin e metodologjisë, pyetësi Illinois Bully Scale, është i ndarë në tre nën shkallë, të cilat masin *Viktimizimin, Bullizmin dhe Agresionin ose Grindjet Fizike*. Pyetjet 04, 05, 06 dhe 07 janë pyetje të cilat masin fenomenin e Viktimizimit. Për analizimin e këtyre nën shkallëve, është bërë një nënkategorizim i tyre, sipas pikëve. Konkretisht, fenomeni i viktimizimit, i cili përmban katër pyetje, ku secila ka vetëm 4 pikë maksimale, ka në total 16 pikë. Një nxënës i cili ka “0” pikë nuk është i përfshirë në viktimizim, një person i cili ka grumbulluar 1-4 pikë është “lehtësisht i përfshirë” në këtë fenomen, një nxënës i cili ka grumbulluar 5-8 pikë është “mesatarisht i përfshirë” dhe nëse i intervistuari ka grumbulluar 9-16 pikë atëherë ky person është “shumë i përfshirë” në fenomenin e viktimizimit. Nëse shohim tabelën e mëposhtme, shumica e nxënësve të intervistuar, 43%, nuk janë të përfshirë në këtë sjellje, ndjekur nga 41% të cilët janë lehtësisht të përfshirë në viktimizim, 10% janë mesatarisht të përfshirë dhe një përqindje shumë e vogël, prej 5% (24 raste) janë shumë të përfshirë në fenomenin e sipërpërmendur. Të dhënat paraqiten numerikisht si dhe grafikisht në grafikun nr.5

Viktimizim			
	Frekunca	%	Valid Percent
Jo te perfshire	206	43.4	43.4
Lehtesisht te perfshire	197	41.5	41.5
Mesatarisht te perfshire	48	10.1	10.1
Shume te perfshire	24	5.1	5.1
Total	475	100.0	100.0

Tabela 14 Fenomeni i viktimizimit



Grafiku 5 Viktimizim

Në tabelën më poshtë behet një shtrirje e viktimizimit ndaj meshkujve dhe femrave. Në rastet ku nxënësit nuk janë fare të përfshirë në këtë fenomen dominojnë femrat ndaj meshkujve. E kundërta ndodh në rastet ku nxënësit janë të përfshirë në viktimizim, pasi janë meshkujt ata të cilët dominojnë mbi femrat në sjellje të tilla.

		Fenomeni i viktimizimit sipas gjinise				Total
		Jo te perfshire	Lehtesisht te perfshire	Mesatarisht te perfshire	Shume te perfshire	
gjinia	Femer	118	97	22	8	249
	Mashkull	88	100	26	16	226
		206	197	48	24	475

Tabela 15 Shtrirja e viktimizimit ndaj meshkujve dhe femrave

❖ Pas vlerësimit të marrëdhënies midis gjinisë dhe sjelljeve viktimizuese, mund të themi se ka një karakter pozitiv statistikiisht domethënës midis sjelljeve viktimizuese dhe gjinisë, konkretisht $P=0.002$ dhe chi square $\chi^2=44.1$. *Pra mund të themi se janë femrat ato të cilat nuk janë aspak të përfshira në sjellje viktimizuese, ndërsa e kundërta ndodh me meshkujt, të cilët janë jo rastësisht të përfshirë në sjellje viktimizuese ($P<0.01$).*

c. Grindjet fizike ose agresioni.

10. Pyetësi I standartizuar që është përdorur në këtë punim, në një prej 3 nënshkallët e tij, mat agresionin ose grindjet fizike të nxënësve. Kjo nënshkallë përfshin pyetjet 03, 10, 11, 12, 13, pra ka në total 20 pikë maksimale. Nënkatëgorizimi I pikëve është si më poshtë:

- 0 pikë → aspak I përfshirë në grindje fizike
- 1-5 pikë → lehtësisht I përfshirë


- 6-11 pikë → mesatarisht I përfshirë
- 12-20 pike → shumë I përfshirë në grindje fizike.

Në tabelën e mëposhtme shohim se 25.9% e nxënësve të intervistuar nuk janë fare të përfshirë në grindje të tilla fizike, ndërsa shumica e të intervistuarve, prej 55% (261 raste) janë “lehtësisht të përfshirë në grindje të tilla fizike”. Vetëm 13% janë “mesatarisht të përfshirë” dhe vetëm 6% janë “shumë të përfshirë” në grindje fizike. Këto të dhëna paraqiten numerikisht si dhe grafikisht në grafikun nr. 6.

❖ Sikurse u procedua dhe me fenomenin e viktimizimit më lart, edhe në këtë rast është bërë një paraqitje e Agresionit apo Grindjeve fizike sipas gjinisë së nxënësve të intervistuar. Vihet re se shumica e femrave të intervistuar nuk janë të përfshira në agresione të tilla fizike. Për sa i përket meshkujve, shumica e tyre, rreth 121 raste janë lehtësisht të përfshirë në sulme fizike dhe dominojnë në mënyrë sinjifikante ndaj femrave. *Pra mund të thuhet se meshkujt janë më të përfshirë në grindje fizike se sa femrat, pasi marrëdhënia midis këtyre dy variablave nuk është rastësore, por ka një karakter sinjifikant, ku $\chi^2 = 47.1$ dhe $P < 0.0001$ (tabela nr.15).*

Fenomeni i agresionit			
	frekuenca	%	% vlefshme
Aspak i përfshirë	123	25.9	25.9
Lehtësisht i përfshirë	261	54.9	54.9
Mesatarisht i përfshirë	63	13.3	13.3
Shumë i përfshirë	28	5.9	5.9
Total	475	100.0	100.0

Tabela 16 Grindjet fizike



Grafiku 6 Shtrirja e grindjeve fizike midis femrave dhe meshkujve

		Agresioni				Total
		Aspak i perfshire	Lehtesisht i perfshire	Mesatarisht i perfshire	Shume i perfshire	
gjinia	Femer	140	86	19	4	249
	Mashkull	37	121	44	24	226
Total		123	261	63	28	475

Tabela 17 Shtirirja e grindjeve fizike midis femrave dhe meshkujve

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	47.100	3	.000
Likelihood Ratio	46.391	3	.000
Linear-by-Linear Association	43.478	1	.000
N of Valid Cases	475		

Tabela 18 Marredhenia midis sjelljeve agresive dhe gjinise

d. **Vlerësimi I fenomenit të bullizmit.**

11. Në këtë pjesë të pyetësorit, e cila përfshin pjesën më të madhe të pyetjeve, konkretisht atë nr. 01, 02, 08, 09, 14, 15, 16, 17, dhe pyetjen nr. 18, merret informacion rreth bullizmit. Kjo nënshkallë është kategorizuar sikurse nënshkallët e tjera. Pra në total janë 36 pikë, të cilat ndahën si më poshtë:

- 0 pikë → nuk është I përfshirë në bullizëm
- 1-9 pikë → paraqet sjellje të lehta bullizmi
- 10-18 pikë → mesatarisht I përfshirë në sjellje të tilla
- 19-36 pikë → shumë I përfshirë.

Nëse shohim në tabelën e mëposhtme, mund të themi se vetëm 16% e nxënësve të intervistuar nuk janë të përfshirë ose nuk kryejnë sjellje bullizmi, ndërsa shumica e tyre, rreth 66% (312 raste nga 475 në total) manifestojnë sjellje të lehta bullizmi. Vetëm 11.8% janë mesatarisht të përfshirë në sjellje të tilla dhe një numër shumë I vogël, vetëm 29 raste manifestojnë sjellje të rënda bullizmi, pra janë shumë të përfshirë në këtë fenomen.

Fenomeni I bullizmit			
	Frekuenca	%	% vlefshme
Aspak i perfshire	78	16.4	16.4
Lehtesisht i perfshire	312	65.7	65.7
Mesatarisht	56	11.8	11.8
Shume i perfshire	29	6.1	6.1
Total	475	100.0	100.0


Tabela 19 Përfshirja në fenomenin e bullizmit

Në tabelën nr.17 është bërë një shpërndarje e sjelljeve bulliste sipas gjinisë së nxënësve të intervistuar. Gjithashtu këto të dhëna janë paraqitur grafikiisht në grafikun nr.7. Vihet re që shumica e femrave, rreth 167 raste manifestojnë sjellje të lehta bulliste, ashtu sikurse shumica e meshkujve, rreth 145 raste.

- ❖ Nëse do të bënim një vlerësim të marrëdhënies midis gjinisë dhe sjelljeve bulliste, atëherë mund të themi se meshkujt, jo rastësisht, manifestojnë më shumë sjellje bulliste në krahasim me femrat, pasi $\chi^2=9.4$ dhe $P=0.004$.

		Bullizmi				Total
		Aspak i perfshire	Lehtesisht i perfshire	Mesatarisht	Shume i perfshire	
gjinia	Femer	48	167	25	9	249
	Mashkull	30	145	31	20	226
Total		78	312	56	29	475

Tabela 20 Shtrirja e bullizmit midis femrave dhe meshkujve



Shpërndarja e bullizmit sipas gjinise

Grafiku 7 Shpërndarja e sjelljeve bulliste midis gjinisë

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	9.429	3	.004
Likelihood Ratio	9.553	3	.003
Linear-by-Linear Association	9.220	1	.002
N of Valid Cases	475		

Tabela 21 Marredhenia midis gjinise dhe bullizmit

e. Sjellje bulliste, agresion apo viktimë e bullizmit?

12. Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, është vlerësuar meatarja e pikëve të grumbulluara për secilën nënshkallë të pyetësorit. Sikurse shihet dhe në tabelën e mëposhtme, nxënësit e intervistuar manifestojnë më shumë sjellje bulliste apo kanë tendencë të reagojnë në mënyrë agresive, me grindje fizike, se sa të ndihen të viktimizuar. Për sjelljet bulliste, mesatarja e pikëve ishte $x=0.641$, për viktimizimin $x=0.52$, ndërsa për grindjet fizike $x=0.646$. Përa I përket kufirit të pikëve mesatare, bullizmi vlerësohet

me 0-4 pikë mesatare, grindjet fizike vlerësohen me 0-4 pikë mesatare, po kështu dhe sjelljet bulliste kanë 0-4 pikë mesatare.

	Bullizmi	Viktimizim	Agresion
Mesatarja	0.6415	0.52	0.646
N	475	475	475
Dev. standart	0.757	0.7613	0.818

Tabela 22 Sjellje bulliste apo viktimë e bullizmit?

f. Vlerësimi I marrëdhënieve midis variablave

13. Për të parë se si ndikojnë variablat tek njëra tjetra, si dhe për të parë nëse marrëdhënia e tyre është rastësore apo sinjifikantë, është përlogaritur chi square P value. Në shohin tabelën e mëposhtme arrijmë në këto përfundime:

❖ Nxënësit të cilët kanë mbarvajtje mësimore jo të mirë, të keqe apo shumë të keqe, kanë tendencë të manifestojn sjellje bulliste ($P=0.007$) si dhe sjellje agresive apo dhunë fizike ndaj bashkëmoshatarve të tyre ($P=0.033$). Marrëdhënia mes këtyre variablave, pra mbarëvajtjes mësimore dhe sjelljeve bulliste e atyre agresive, është e karakterit sinjifikant, pasi $P<0.05$.

❖ Vihet re se meshkujt janë më shumë të përfshirë në sjellje viktimizuese, agresive dhe sjellje bulliste, krahasuar me femrat (përkatesisht $P=0.031$, $P<0.0001$, $P,0.0001$).

❖ Mund të thuhet se nxënësit e klasave më të larta paraqesnin më shumë sjellje agresive dhe bulliste se sa ata të klasave më të ulta ($P<0.0001$) Klasa në të cilën studionte nxënësi nuk kishte ndikim mbi viktimizimin pasi $P>0.05$.

❖ Nëse do të shqyrtonim lidhjen midis vendbanimit dhe sjelljeve të nxënësve, mund të themi se personat të cilët jetojnë në periferi janë të prirur të grinden fizikisht me bashkëmoshatarët ($P=0.014$)

❖ Është vlerësuar lidhja midis vetë sjelljeve të cilat janë analizuar në këtë punim. Vihet re se midis sjelljeve agresive dhe viktimizimit ekziston një marrëdhënie positive sinjifikante, ku $P<0.0001$, cka nënkupton se rritja e njëres variabël çon në rritje të variablës tjetër. Me pak fjalë, nxënësit të cilët viktimizohen kanë shumë mundësi të manifestojnë sjellje agresive, dhe anasjelltas.

❖ Po ashtu është vlerësuar marrëdhënia midis viktimizimit dhe sjelljeve bulliste, ku rezultoi $P<0.000$, pra dhe kjo marrëdhënie është positive, statistikisht domethënëse, që tregon se personat të cilët viktimizohen do të manifestojnë dhe sjellje bulliste, si dhe anasjelltas. E njejta marrëdhënie ekziston edhe midis agresioni dhe sjelljeve bulliste, të cilat nxisin njëra tjetrën, jo rastësisht, pasi marrëdhënia midis tyre është statistikisht domethënëse, ku $P<0.0001$.

❖ Sikurse u veprua dhe me variablat e mësipërme, është vlerëuar dhe marrëdhënia midis sjelljeve agresive dhe atyre bulliste. Pas përpunimit të të dhënave, u vërejt se nxënësit të cilët shfaqin sjellje agresive, manifestojnë gjithashtu dhe sjellje bulliste. Marrëdhënia midis këtyre variablave është sinjifikante positive, ku $P<0.0001$.

Marredhenia midis variablave	P-value
Mbarevajtje mesimore*Agresion	0.33
Mbarevajtja mesimore* bullizem	0.007
Gjinia *Viktimizim	0.31
Gjinia *Agresion	0.0001
Gjinia*Bullizëm	0.002
Viktimizim*Bullizëm	0.0001
Agresion * Bullizem	0.0001
Vendbanim* Agresion	0.014

Tabela 23 Vlerësimi i marrëdhënieve mes variablave

Mrredhenia midis BMI dhe fenomeneve me poshte	
	BMI
Viktimizim ²³⁴	.026 .575 453
Grindjafizike ¹	.164 .000 453
Bullizmi	.151 .001 453

Tabela 24 Ndikimi i BMI në fenomenet e bullizmit

Pas vlerësimit të marrëdhënieve midis BMI dhe fenomeneve të cilat mat pyetësi, vihen re rritje të agresionit dhe bullizmit në personat të cilët kanë BMI të rritur në vlerë (përkatësisht $P= 0.001$ dhe $P<0.0001$). Nuk vihet re ndikim sinjifikant në fenomenin e viktimizimit.

IV. Diskutim

Bullizmi është një fenomen kompleks heterogjen, I cili prek qindar dhe miliona persona çdo vit. Rëndësia e bullizmit ka stimuluar realizimin e shumë studimeve, të cilat janë nxitur fillimisht nga përcaktimi që I ka bërë këtij fenomeni Olweus në vitin 1993. Bullizmi është përkufizuar në mënyrë tradicionale si një agresion I përsëritur apo veprime dëmtuese drejtuar individëve target, të cilët kanë disavantazhe ose gëzojnë më pak fuqi në ndërveprimet sociale me bashkëmoshatarët. (10) Edhe pse ka diskutime të mëdha në gjetjen e përkufizimit të saktë rreth këtij fenomeni, një tërësi studimesh po përpiqen të adoptojnë këtë përkufizim tradicional, duke e vendosur brenda një kornize social-ekologjike, pra bullizmi po kuptohet dhe ekzaminohet si një fenomen shoqëror, I krijuar nga bashkëveprimi I faktorëve individual dhe atyre kontekstual. (11) Pra fjala “agresion” apo “veprime dëmtuese” duhet të zëvendësohet në përkufizimin tradicional me “veprime qëllimore”, në kuptimin që studentët të cilët manifestojnë sjellje të tilla nuk kanë për qëllim të dëmtojnë por të arrijnë një qëllim të caktuar, apo të fitojnë reputacionin/ dominancën sociale. (12) Sipas Salmivalli dhe Thornberg, termi bullizëm ka vend vetëm tek studentët të cilët e interpretojnë atë si shaka apo lojëra të dëmshme, pra problemi qëndron në përcaktimin e kufirit “ku përfundon shakaja dhe kur fillon abuzimi” (13)

Edhe nëse merret në konsideratë qëllimi I mirë i këtyre sjelljeve, dëmi I shkaktuar tek fëmijët apo adoleshentët e këtyre moshave mund të jetë I parikthyeshëm, duke shkaktuar çekuilibrim gjatë gjithë jetës. Bullizmi, kryesisht në fëmijët e shkollave 9-vjeçare, përbën një problem madhor të shëndetit public. (14) Studijuesit kanë gjetur një kategori tjetër, përveç bullistve, atë të viktimave të bullizmit. Ata demonstronë se viktimat e bullizmit janë më në risk se sa vetë bullistët, pasi raportohen më shumë dëmtime psikologjike, psikosomatike, ulje e vetëbesimit dhe arritjeve shkollore, ankth, depression, etj. Nisur nga kjo janë krijuar dy kategori, ajo e bullistëve dhe e viktimave të bullizmit. (15) Nisur nga kjo arsye, sikurse shumë studime të tjera në këtë fushë, ky punim ka për qëllim vlerësimin e bullizmit në shkollat 9-vjeçare, duke përdorur si instrument Illinois Bully Scale (IBS). Nëpërmjet këtij pyetësoi të standartizuar do të maten tre fenomene në nxënësit e intervistuar, konkretisht bullizmi, viktimizimi dhe agresioni. (16) Si studime të marra në konsideratë mund të përmendim “*Bullying, Victimization and Fighting in Secondary School*”: Gender-Based Differences, Varsha Saini dhe Shanti Balda, Education Department, Haryana, India, Collage of Home Science, I realizuar në vitin 2019.

Mund të përmendim studime të tjera, të cilat nuk kanë përdorur të njëjtin instrument matës, por kanë studjuar të njëjtat fenomene, si “*Prevalence and correlates of bullying and victimization among school students in rural Egypt*” I realizuar në vitin 2019.

Një tjetër studim I cili vlerëson sjelljet e moshave të shkollave 9-vjeçare është “*Trends in Bullying, Physical Fighting, and Weapon Carrying Among 6th- Through 10th-Grade Students From 1998 to 2010: Findings From a National Study*”. (17)

Në këtë punim janë shpërndarë pyetësorë IBS, të përshtatur në gjuhën tonë, në 5 shkollat 9-vjeçare të qytetit të Vlorës, ku në total janë intervistuar N=475 nxënës prej klasës së 5-të deri në klasën e 9-të. Shumica e nxënësve të intervistuar janë femra duke përbërë 52% (249 raste) të rasteve dhe meshkuj 48% (226 raste). Është marrë informacion rreth moshës, klasës si dhe vendbanimit të tyre. Përsa I përket këtij të fundit, shumica e nxënësve të intervistuar, rreth 66% jetojnë në qendër të qytetit, 27% jetojnë në periferi dhe vetëm 7% jetojnë në një fshat apo qytet tjetër.


Sikurse është përmendur edhe në kapitullin e Metodologjisë, pyetësi I përdorur IBS, mat tre fenomene, ku secila prej tyre është kategorizuar nga “aspak I përfshirë” deri në “shumë I përfshirë”. Përsa I përket **fenomenit të viktimizimit**, nga të dhënat shohim se 43% e rasteve, pra shumica e nxënësve të intervistuar nuk janë aspak të përfshirë në këtë fenomen, ndjekur nga 40% të cilët janë lehtësisht të përfshirë në këtë fenomen. Kryesisht të përfshirë janë meshkujt, ndryshe nga studimet të cilat I kemi marrë në konsideratë. Përshembull, në studimin e realizuar në Indi, janë femrat ato të cilat janë lehtësisht të viktimizuara (66.5%), dhe jo meshkujt sikurse ndodh në punimin tonë. Përfundimisht, mund të themi se nxënësit që ne kemi marrë në studim, shumica e tyre, 43%, nuk janë në rolin e viktimave të bullizmit.

Përsa I përket **agresionit apo përfshirjes në grindje fizike**, në këtë punim rreth 55% e të gjitha rasteve janë lehtësisht të përfshirë ose manifestojnë sjellje të lehta agresive, ku kryesisht janë meshkujt ata të cilët shfaqin këto sjellje ($P < 0.0001$). Ky fenomen është vënë re edhe në studimin e realizuar në Indi, të cilin e kemi marrë në konsideratë në këtë punim, ku është gjetur se shumica e nxënësve të intervistuar janë lehtësisht të përfshirë në grindje fizike, madje janë meshkujt ata të cilët manifestojnë më shumë aggression se sa femrat. Në studimin “*Bullying victimization and physical fighting among Venezuelan adolescents in Barinas*” është parë se meshkujt janë 4 herë më shumë të përfshirë në sulme agresive krahasuar me femrat. Kjo predominancë e meshkujve në grindjet fizike është raportuar dhe në shumë studime të tjera, e cila mendohet se mund të vijë si pasojë e tolerancës shoqërore ndaj këtij seksi. (18)

Përsa I përket **fenomenit të bullizmit**, është vënë re se shumica e nxënësve të intervistuar janë lehtësisht të përfshirë në këtë fenomen, pra 66% e rasteve manifestojnë sjellje të lehta bulliste, ku sërisht në këtë fenomen janë meshkujt ata të cilët dominojnë ndaj femrave, me një diferencë sinjifikante ($P = 0.002$). Në studimin e marrë në konsideratë, atë të realizuar në Indi, shumica e femrave ishin të përfshira në sjellje të lehta bulliste, krahasuar me meshkujt, por ishin meshkujt ata të cilët dominonin në format e moderuara dhe të rënda të bullizmit. Gjetje të tilla janë vënë re edhe në studimet e sipërpërmendura.

Bullist, viktimë e bullizmit apo agresiv???

Të dhënat tregojnë se rreth 30% e adoleshentëve raportojnë të paktën një eksperiencë bulliste të moderuar, si bullist, viktimë apo të dyja sëbashku. Specifikisht, 13% raportojnë se kanë qënë në rolin e bullistit, 11% e tyre kanë qënë në rolin e viktimës dhe vetëm 6% I kanë marrë të dyja pozicionet. (14) Nëse shqyrtojmë të dhënat e përftuara nga punimi ynë vihet re se nxënësit e intervistuar shfaqin më tepër sjellje agresive (mesatare pikësh $x = 0.646$, ku min 0 pike dhe max 4 pikë), ndjekur nga sjellje bulliste (mesatare pikësh $x = 0.641$, ku min 0 pike dhe max 4 pikë) dhe së fundmi viktimë të bullizmit (mesatare pikësh $x = 0.52$, ku min 0 pike dhe max 4 pikë).





Bullizem \longleftrightarrow **Viktme**

Ka shumë studime të cilat janë përpjekur të eksplorojnë karakteristikat e ndryshme të viktimës/ bullizmit, se si shkaktojnë ato depresion apo agresion, ulje të performancës mësimore si dhe vetëbesimit. Është arritur në përfundimin se një viktimë mund të kthehet në bullist duke manifestuar agresion apo forma të tjera, ashtu sikurse një bullist të shndërrohet në viktimë, pra të gjitha këto fenomene ndikojnë në nxitjen e njëra-tjetrës. (19) Në studimin e realizuar me adoleshentët venezuelian u vu re se personat të cilët kishin episode viktimizimi, kishin marrë pjesë në agresione të ndryshme, si dhe anasjelltas. Në këtë punim, u vu re se marrëdhënia midis këtyre tre fenomeneve ishin sinjifikante positive ($P < 0.0001$), çka do të thotë se sjelljet bulliste nxisin agresionin dhe anasjelltas, po ashtu të qënurit viktimë nxit sjelljet bulliste dhe agresionin. Të treja këto fenomene nxisin zhvillimin e njëra tjetrës.

Vlefshmëria e të dhënave. Për të vlerësuar konsistencën e brendshme të të dhënave të grumbulluara në këtë pyetësor është llogaritur koeficienti Cronbach Alpha, I cili është në nivelet optimale, për secilin nga fenomenet që mat pyetësori, konkretisht bullizmi ka një $\alpha^1 = 0.772$, viktimizimi $\alpha^2 = 0.759$ dhe agresioni ka koeficient Cronbach $\alpha^3 = 0.791$.

Është venë re se nxënësit të cilët kanë arritje jo të mira mësimore janë më shumë të përfshirë në fenomenet e agresionit apo bullizmit, nga ana tjetër viktimat e bullizmit, përpos dëmtimeve psikologjike apo somatike, pësojnë dhe ulje të performancës së tyre mësimore. (15) Rezultatet të ngjashme vihen re dhe në këtë punim, ku mund të themi se nxënësit të cilët deklarojnë se nuk kanë mbarëvajtje të mirë mësimore, manifestojnë më shumë sjellje bulliste dhe agresion (përkatesisht $P = 0.007$ dhe $P = 0.033$).

Gjithashtu, shumë kërkime në këtë fushë kanë vënë re se viktimat e bullizmit janë dhe personat të cilët nuk kanë një peshë normale në përputhje me moshën, ose BMI jashtë normave. (20) Pas vlerësimit të marrëdhënieve midis BMI dhe fenomeneve të cilat mat pyetësori, vihen re rritje të agresionit dhe bullizmit në personat të cilët kanë BMI të rritur në vlerë (përkatesisht $P = 0.001$ dhe $P < 0.0001$). Nuk vihet re ndikim sinjifikant në fenomenin e viktimizimit.

a. Vlerësimi i hipotezave të punimit

Hipoteza 1 “Meshkujt janë më agresiv se sa femrat”

Për sa i përket meshkujve, shumica e tyre, rreth 121 raste janë lehtësisht të përfshirë në sulme fizike dhe dominojnë në mënyrë sinjifikante ndaj femrave. Pra mund të thuhet se meshkujt janë më të përfshirë në grindje fizike se sa femrat, pasi marrëdhënia midis këtyre dy variablave nuk është rastësore, por ka një karakter sinjifikant, ku $P < 0.0001$.

Hipoteza e mësipërme pranohet.

Hipoteza 2 “Nxënësit manifestojnë më shumë sjellje bulliste sesa viktimizohen”

Nxënësit e intervistuar manifestojnë më shumë sjellje bulliste apo kanë tendencë të reagojnë në mënyrë agresive, me grindje fizike, se sa të ndihen të viktimizuar, pasi për

sjelljet bulliste, mesatarja e pikëve ishte $x=0.641$, për viktimizimin $x=0.52$, ndërsa për grindjet fizike $x=0.646$. Përa I përket kufirit të pikëve mesatare, bullizmi vlerësohet me 0-4 pikë mesatare, grindjet fizike vlerësohen me 0-4 pikë mesatare, po kështu dhe sjelljet bulliste kanë 0-4 pikë mesatare.

Hipoteza e mësipërme pranohet.

Hipoteza 3 “Nxënësit të cilët manifestojnë sjellje bulliste kanë ecuri të keqe mësimore”

Nxënësit të cilët kanë mbarvajtje mësimore jo të mirë, të keqe apo shumë të keqe, kanë tendencë të manifestojnë sjellje bulliste ($P=0.007$), pasi marrëdhënia mes këtyre variablave, pra mbarëvajtjes mësimore dhe sjelljeve bulliste është e karakterit sinjifikant, pasi $P<0.05$.

Hipoteza e sipërme pranohet.

Hipoteza 4 “Sjelljet bulliste nxisin sjelljet agresive”

E njejta marrëdhënie ekziston edhe midis agresioni dhe sjelljeve bulliste, të cilat nxisin njëra tjetrën, jo rastësisht, pasi marrëdhënia midis tyre është statistikisht domethënëse, ku $P<0.0001$ dhe.

Hipoteza e mësipërme pranohet.

Hipoteza 5 “Femrat viktimizohen më shumë se sa meshkujt”

Pas vlerësimit të marrëdhënies midis gjinisë dhe sjelljeve viktimizuese, mund të themi se ka një karakter pozitiv statistikisht domethënës midis sjelljeve viktimizuese dhe gjinisë, konkretisht $P=0.031$ dhe $r=0.087$. Pra mund të themi se janë femrat ato të cilat nuk janë aspak të përfshira në sjellje viktimizuese, ndërsa e kundërta ndodh me meshkujt, të cilët janë jo rastësisht të përfshirë në sjellje viktimizuese ($P<0.05$).

Hipoteza e mësipërme nuk pranohet.

V. Konkluzione

Pas përpunimit të të dhënave të grumbulluara nga pyetësorët e shpërndarë në shkollat 9-vjeçare të qytetit, u përfunduan konkluzionet e mëposhtme:

1. Në total u intervistuar 475 nxënës, ku përafërsisht 18% (84 raste) janë nxënës në shkollën “Avni Rustemi”, 26%(123 raste) e të intervistuarve janë nxënës të cilët studiojnë në shkollën “Muco Delo”, vetëm 5.5% (26 raste) janë nxënës të shkollës “Perla”. Shumica e të intervistuarve, rreth 27% (128 raste) janë nxënës të shkollës jopublike “Elite” dhe 24% (114 raste) janë nxënës të shkollës “Lef Sallata”.

2. Shumica e nxënësve të intervistuar janë femra, në një përqindje prej 52% (249 raste), ndërsa meshkuj janë përafërsisht 48% (226 raste).

3. Në këtë punim janë marrë nxënës të shkollave 9-vjecare, konkretisht nxënës nga klasa e 5-të deri në atë të 9-të. Shumica e të intervistuarve, 24%, I përket moshës 14-vjecare, ndjekur nga 12 vjecarët me 19%, e kështu me rradhë të gjitha moshat, nga 10 vjeç deri në 19 vjeç.

4. Shumica e nxënësve të anketuar I përkasin klasës së 9-të, me 25% (120 raste), ndjekur nga klasa e 6-të, me 21% (100 raste).

5. Përsa I përket vendbanimit të nxënësve të intervistuar, shumica e tyre, 66%, shprehen se jetojnë në qendër të qytetit, ndjekur nga 27% e tyre, të cilët jetojnë në periferi dhe vetëm 35% e nxënësve shprehen se jetojnë në një fshat apo qytet tjetër dhe studiojnë në shkollat e sipërpërmendura.

6. Duke qënë se nxënësit kanë deklaruar gjatësinë dhe peshën e tyre, për aq sa ata kishin informacion, është llogaritur BMI (Body Mass Index). Mesatarja e BMI për rastet e intervistuar është 19.55, me Dev. Stan=5.02. Për llogaritjen e BMI janë shqyrtuar 453 raste, nga 475 raste në total, cka do të thotë që 22 raste kanë mungesë të dhënash (peshë ose gjatësi, pa të cilat nuk mund të zbatohet formula e llogaritjes së BMI).

7. Përsa I përket mbarëvajtjes mësimore, rreth 30% e tyre shprehen se kanë një ecuri “të mirë” në shkollë, shumica e nxënësve, 51.4% e tyre, shprehen se kanë një ecuri “shumë të mirë”, 14% shprehen se kanë një ecuri mesatare dhe shumë pak raste, vetëm 1.5% dhe 2% shprehen se janë “keq” ose “shumë keq” në mësim.

8. Fenomeni I viktimizimit. Shumica e nxënësve të intervistuar, 43%, nuk janë të përfshirë në këtë sjellje, ndjekur nga 41% të cilët janë lehtësisht të përfshirë në viktimizim, 10% janë mesatarisht të përfshirë dhe një përqindje shumë e vogël, prej 5% (24 raste) janë shumë të përfshirë në fenomenin e sipërpërm. Gjinia që është më shumë e përfshirë në këtë fenomen janë meshkujt, $P < 0.05$.

9. Agresioni. shohim se 25.9% e nxënësve të intervistuar nuk janë fare të përfshirë në grindje të tilla fizike, ndërsa shumica e të intervistuarve, prej 55% (261 raste) janë “lehtësisht të përfshirë në grindje të tilla fizike”. Vetëm 13% janë “mesatarisht të përfshirë” dhe vetëm 6% janë “shumë të përfshirë” në grindje fizike. Serisht janë meshkujt ata të cilit predominojnë në këtë fenomen $P < 0.0001$.

10. Bullizmi. Mund të themi se vetëm 16% e nxënësve të intervistuar nuk janë të përfshirë ose nuk kryejnë sjellje bullizmi, ndërsa shumica e tyre, rreth 66% (312 raste nga 475 në total) manifestojnë sjellje të lehta bullizmi. Vetëm 11.8% janë mesatarisht të përfshirë në sjellje të tilla dhe një numër shumë I vogël, vetëm 29 raste manifestojnë sjellje të rënda bullizmi, pra janë shumë të përfshirë në këtë fenomen. Edhe në këtë fenomen janë meshkujt që dominojnë, $P = 0.002$.

11. Ndër tre fenomenet të cilat u shqyrtuan në këtë punim, mund të themi se nxënësit e intervistuar manifestojnë më shumë sjellje bulliste apo kanë tendencë të reagojnë në mënyrë agresive, me grindje fizike, se sa të ndihen të viktimizuar. Për sjelljet bulliste, mesatarja e pikëve ishte $x = 0.641$, për viktimizimin $x = 0.52$, ndërsa për grindjet fizike $x = 0.646$ (0 pike min dhe 4 pike max).

12. Të treja fenomenet kishin ndikim sinjifikant të ndërsjelltë ndaj njera-tjetrës. Fenomenet agresive nxizin bullizmin apo viktimizimin si dhe anasjelltas. Të njëjtin relacion mund të themi dhe për bullizmin apo viktimizimin.

13. Bullizmi dhe agresioni ndikonin në mënyrë sinjifikante mbi mbarëvajtjen mësimore dhe anasjelltas.

VI. Rekomandime

Bazuar në të dhënat e përftuara nga përpunimi statistikor, mund të themi:

- Duke qënë se në këtë punim janë intervistuar vetëm nxënës të 5 shkollave 9-vjeçare, rekomandohet zgjerimi i studimit në më shumë shkolla dhe nxënës, si në zonat rurale ashtu dhe në ato urbane, në mënyrë që të krijohet një panoramë sa më e plotë e këtyre fenomeneve në këto grupmosha.
- Në këtë punim rezultoi që meshkujt janë më të prekur në sjelljet viktimizuese, bulliste apo agresion, çka kërkon rritjen e vigjilencës dhe programeve të ndërhyrjes në këtë gjini. Shumë metoda të përfshirjes së tyre në aktivitete të ndryshme sportive apo kreative, I shpërqëndron ata nga sjelljen e sipërpërmendura.
- Duhet të nxiten dhe të ushqehen marrëdhënie të shëndetshme midis bashkëmoshatarve gjate gjithë procesit mësimor me qëllim krijimin e nje filozofie apo nje fryme positive ne shoqëri.
- Duke parë rezultatet e këtij punimi, sjelljet si bullizmi, agresioni apo viktimizimi, janë në fillimet e veta, nënësir manifestonin sjellje të lehta viktimizuese, bulliste dhe agresioni. Ndërhyrjet edukative apo parandaluese në këtë fazë mund të rezultojnë efikase.
- Duke marrë në konsideratë marrëdhënien e fenomeneve me njëri-tjetrit viktime-bullizëm- agresion, minimizimi I njërit prej tyre do të çojë në uljen e manifestimit të fenomenit tjetër.
- Të gjithë nxënësit, e gjithë shoqëria duhet të njoh fenomenin e bullizmit si dhe të gjitha format e shfaqjes së tij, në mënyrë që më tej të dallojnë sjelljet jo të përshtatshme.
- Nxënësit duhet të fuqizohen të denoncojnë të gjitha rastet kur ndihen të kërcënuar apo janë në dijeni të rasteve të tilla.
- Duhet të implementohet një sistem vlerësimi për të gjithë të rinjtë, I cili mund të realizohet nga psikologu I shkollës dhe jo vetëm, pasi të gjithë profesionistët e arsimit mund të jenë shumë afër sjelljeve bulliste apo agresive që të rinjtë ushtrojnë ndaj njëri-tjetrit. Mësuesit mund të menaxhojnë teknika specifike të cilat të shpërndajnë sjelljet dëmtuese, duke shmangur teknikat ndëshkuese.
- Të gjitha sistemet parandaluese apo programet e ndërhyrjeve duhet të adresojnë qëllimin e tyre në evidentimin e viktimave të fshehura të bullizmit.
- Të gjithë të rinjtë duhet të jenë të supervizuar nga adultët si në mjediset e tyre shtëpiake ashtu dhe në ato shkollore, derisa fryma positive kundër sjelljeve bulliste të bëhet një normë për shoqërinë.

VII. Anekse 1

Pyetësor

Për secilën nga pyetjet më poshtë shënoni sa herë ju e keni bërë këtë gjë ose sa herë ka ndodhur tek juve 30 ditët e fundit:

Pyetësi është anonim dhe çdo përgjigje do të mbahet sekret .

Faleminderit për bashkëpunimin !

1. **Gjinia :** Femër Mashkull
2. **Mosha :** Vjeç
3. **Klasa :**
4. **Venbanimi :** Periferi qender e qytetit fshat/qytet tjetër
5. **Pesha :**Kg
6. **Gjatësia :**Cm
7. **Mbarevajtja juaj mesimore :** mire shume mire as mire as keq keq
shume keq

		Kurrë	1 ose 2 herë	3 ose 4 herë	5 ose 6 herë	7 ose më shumë herë
8	Unë kam ngacmuar nxënës të tjerë për shaka					
9	Kur jemi shumë veta (në grup) unë kam ngacmuar nxënës të tjerë					
10	Unë zihem me nxënës të tjerë që mund tu fitoj lehtë					
11	Nxënësit e tjerë më ngacmojnë					
12	Nxënësit e tjerë tallen me mua					

13	Nxënësit e tjerë me thërrasin me pseudonime					
14	Nxënësit e tjerë më kanë shtytur dhe më kanë goditur					
		Kurrë	1 ose 2 herë	3 ose 4 herë	5 ose 6 herë	7 ose më shumë herë
15	Unë kam ndihmuar që të ngacmojmë nxënës të tjerë					
16	Unë ngacmoj nxënës të tjerë					
17	Unë jam përfshirë në zënka fizike (rrahje)					
18	Unë kam kërcënuar nxënës të tjerë se do ti lëndoj ose godas					
19	Unë jam zënë fizikisht me të tjerë sepse kam qënë i nevrikosur					
20	Nëse dikush më qëllon i pari edhe unë e qëlloj					
21	Unë i kam folur keq dikujt kur kam qënë i inatosur (zëmëruar)					
22	Unë kam përhapur thashetheme për nxënës të tjerë					
23	Unë kam filluar (ose edhe kam nxitur) zënie ose konflikte					
24	Unë kam inkurajuar të tjerë të zihen					

25	Unë kam përjashtuar nxënës të tjerë nga shoqëria ime					
----	--	--	--	--	--	--

Ju faleminderit që morrët pjesë në këtë studim!!!

VIII. Referenca

1. **Solberg, M and Olweus , D.** *Prevalence estimation of school bullying with the Olweus,Bully/Victim Questionnaire.* 2003.
2. **Dragoti, E and Ismaili, E.** *Studim Kombëtar mbi Bullizmin dhe Ekstremizmin e Dhunshëm në Sistemin Arsimit Shqiptar.* 2017.
3. **Moore, E S, et al., et al.** *Consequences of bullying victimization in childhood and adolescence: A systematic review and meta-analysis.* s.l. : World Journal of psychiatry, 2017.
4. **Ismaili, S.** *Bullizmi ne shkollat 9-vjeçare te Tiranës.* 2015.
5. **Limo, S.** *Bullying among teenagers and its effects.*turko university of Applied. 2015.
6. **Kokkinos, E and Panayiotou, G.** *Predicting Bullying and Victimization Among Early Adolescents: Associations With Disruptive Behavior Disorders.* 2004.
7. **Seo, H J, et al., et al.** *Factors associated with bullying victimization among Korean adolescents. Neuropsychiatric disease and treatment,.* 2017.
8. **Mohseny, M, Zamani, Z and Akhondzadeh Basti, S.** *Bullying and Victimization among students bears relationship with gender and emotional and behavioral problems.* s.l. : Iran j Psychiatry, 2019. pp. 211-220.
9. **Galal, YS, Emadeldin, M and Mwafy, MA.** *Prevalence and correlates of bullying, victimization among school students in rural Egypt.* s.l. : J Egypt public Health Assoc, 2019.
10. **Chalmers , C, et al., et al.** *School Policies on Bullying and Cyberbullying: Perspectives across Three Australian States.* s.l. : Educational research, 2016. pp. 91-109.
11. **Espelage, D L and Swearer, S M.** *Bullying in North American Schools.* New York : s.n., 2011.
12. **Lyznicki, JM, Mccaffree, MA and Robinowitz, CB.** *Childhood bullying: implications for physicians.* s.l. : Am Fam Physician, 2004. pp. 1723-1728.
13. **Terasahjo, T and Salmivalli, C.** *She Is Not Actually Bullied': The Discourse of Harassment in Student Groups."* *Aggressive Behavior.* 2003. pp. 134-145.
14. **Nansel , T R, et al., et al.** *Bullying behaviors among US youth: Prevalence and association with psychosocial adjustment.* s.l. : Journal of the American medical Association, 2001. pp. 2094-2100.
15. **Forero, R, et al., et al.** *Bullying behavior and psychosocial health among school students in New South Wales, Australia: A cross sectional survey.* s.l. : British Medical Journal, 2001. pp. 319-344.
16. **Boulton, M J and Underwork, K.** *Bully/victim problem among middle school children.* s.l. : British Journal of Educational Psychology, 1992. pp. 73-87.

17. **Perlus, JG, et al., et al.** *Trends in bullying, physical fighting, and weapon carrying among 6th- through 10th-grade students from 1998 to 2010 : findings from a national study.* s.l. : Am J Public Health, 2014. pp. 1100-1106.
18. **Rudatsikira, E, et al., et al.** *Prevalence and associated factors of physical fighting among school-going adolescents in Namibia.* s.l. : Ann Gen Psychiatry, 2007.
19. **Saamara, M, et al., et al.** *Bullying and Cyberbullying: Their Legal Status and Use in Psychological Assessment.* s.l. : Int J , 2017.
20. **Wang, C, et al., et al.** *Body Weight and Bullying Victimization among US Adolescents.* . s.l. : Am J Health Behavior, 2018.